

# Krishtlindjen Gëzuar Vitin e Ri 2016



## Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 146, dhjetor 2015  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

# Realizimet e vitit 2015

NJË EKSPERIENCË E MADHE PËR TU MBËSHTETUR NË REALIZIMIN E MISIONIT  
TË SHOQATËS "ATDHTARE-DUKAGJINI", NË VITIN 2016 2

## Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani, pret në Presidencë përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Ditën e mërkurë, më 17 Nëntor 2015, në Presidencë u zhvillua një pritje, ku Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Bujar NISHANI, priti një përfaqësi të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Objekti kryesor i takimit ishte falenderimi dhe mirënjohja që Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe gjithë zona dëshironte të shprehte Presidentit të Republikës në lidhje me vlerësimin e disa figurave dukagjinase...

## GOXO QË TË FTOSH

PROMOVHET ROMANI "GUXO" I SHKRIMTARIT FADIL KRAJA, KUSHTUAR BIZNESMENIT TË SUKSESSHËM SHQIPTARO-AMERIKAN NDUE FTONI



## Heroi i Popullit Dedë Gjo' Luli

NDEROHET NË KRYEQYTETIN E SHQIPËRISË

Me datën 27 nëntor 2015, një ditë para 103 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ose një ditë para Ditës së Flamurit, në orën 11.00 u përurua monumenti i Heroit të Popullit, Dede Gjon Luli. Vërtetë një krenari e veçantë, që pas 100 vitesh të rënies së këtij tribune të lirisë, të vendoset përjetësisht në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, në kryeqytetin e shtetit Amë, Tirane.



## Kodi i gjetjes me dinjitet të vetvetes

- DUKE SHFLETUAR ROMANIN "GUXO!...", TË SHKRIMTARIT FADIL KRAJA -

Dashnori i fjalës si vlerë universale, dramaturgu dhe po aq romancier i konfirmuar, "Mjeshtri i Madh", Fadil Kraja, i mirënjohur për prirjen estetike të përjetimit të fatit të njeriut të thjeshtë, vjen kësaj radhe me një mesazh të ri, original dhe po aq intrigues: Kodi i gjetjes me dinjitet të vetvetes, ndryshe Individualizmi, si filozofi, sfida më serioze për njeriun bashkëkohor.

# Realizimet e vitit 2015

## NJË EKSPERIENCË E MADHE PËR TU MBËSHTETUR NË REALIZIMIN E MISIONIT TË SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI", NË VITIN 2016

Me punën e pa lodhur të anëtarëve të kryesisë, me mbështetjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe anëtarëve të saj, gjate vitit 2015 janë realizuar një sere veprimtarish në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të shoqërisë civile dhe kulturore, me strukturat e pushtetit vendor në qytetin tone, Shkodrën, në mbare hapësirat shqiptare. Këto veprimtari janë:

**Së pari**, në saj të punës së redaksisë me në krye kryeredaktorin, Luigj Shyti, gazeta ka dale rregullisht, në çdo muaj. Për nxjerrjen e saj kane vijuar të kontribuojnë financiarisht, zoti Ndue Ftoni dhe zoti Gjergj Leqejza, të cilët në emër të redaksisë, të kryesisë dhe anëtarëve të shoqatës, i falënderojmë jashtë mase për këtë kontribut që kane dhënë dhe japin në nxjerrjen e kësaj gazete, që është e vetmja gazete e qytetit të Shkodrës, që del në treg. Doli nga shtypi nr. 146 i saj.

Në këtë vit, në 12 numra gazete, nga numri 135 e deri te numri 146, janë botuar 162 artikuj nga 66 artikull shkruar. Këta janë: Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Ndoc Selimi, Beqir Cikaqi, Zef Nika, Prele Milani, Kadri Ujkaj, Mark Bregu, Prele Shytani, Ramazan Ceka, Zejnepe Haliti, Kryesia e Shoqates, Alfred Popuçiu, Burimi Ballkanëeb, Ahmet Dursun, Rush Dragu, Martin Çetina, Suela Ndoja, Haki Temali, Maliq Vreka, Arben Legreta, Besi Bekteshi, Ndoc Logu, Leke Imeraj, Sejman Sokoli, Mhill Pali, Gazmend Krasniqi, Mirash Ndrezaj, Mirash Uka, Beqir Sina, Dede Zhivani, Nike Bujaj, Ndue Nika, Luigj Temali, Ndue Mici, Lazer Kodra, Gjon Fierza, Zef Pergega, Dashmir Cacaj, Lulash Brigja, Rrok Lazeri, Agron Luka, Lazer Preka, Ylli Mece, Zef Gjeta Marinela Buxha, Zef Lulash Sokoli, Tonin Macaj, Frasher Racaj, Zef Fusha, Luigj Mila, Alda Bardhyli, Kole Bala, Nike Gashaj, Zef Deilja, Ndoc Grimaj, Lazer Stani, Gjergj Leqejza, Sadik Bejko, Daniela Pjetri dhe Roza Pjetri. Të gjithë i falënderojmë për këtë kontribut intelektual që kane dhënë.

**Së dyti**, me datën 12-13 prill, morëm pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2015", në kuadrin e 15 vjetorit të themelimit të Shoqatës së Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Peje.

**Së treti**, me datën 30-31 tetor ishim në Peje, në kuadrin e 25 vjetorit të themelimit të Teatrit "Aleksandër Moisiu" dhe në Dobërdol të komunës së Klinës, në "Ditën e Plisit".

**Së katërti**, me datën 14 nëntor u paraqit romani, me titull "GUXO...!" të autorit Fadil Kraja, që i kushtohet një anëtari të Shoqatës sonë, i cili është një nder kontribuuesit kryesor, Ndue Ftonit, biznesmen në Miçigan të SHBA.

**Së pesti**, me kërkesën tone dhe me mbështetjen e këshilltarit diplomatik për rajonin, zotit Flamur Gashi, me datën 18 nëntor u takuam me Presidentin e Republikës, zotin Bujar Nishani. Një takim i planifikuar në orën 16.00 deri në orën 16.15, zgjati deri në orën 16.45. Grupi përfaqësues i shoqatës ishim unë, Gjergji, Roza, Zef Gjeta, Lazer Stani, Zef Bari dhe Zef L. Sokoli. Në emër të gjithë shoqatës e informuam shkurtimisht për punën e shoqatës në këto 13 vite dhe i dhuruam logon e shoqatës, me këtë motivacion: "Në shenjë respekti e mirënjohje për vlerësimin dhe promovimin që i keni bere figurave të zonës së Dukagjinit, për kontributin e tyre në çështjen shqiptare". Nga Zef L. Sokoli, në emër të shoqatës i dhuroi një veshje tradicionale, si dhe prof. As. Dr. Zef Gjeta, në emër të shoqatës i dhuroi 8 libra të shkruar nga autoret Prele Milani e Lazer Kodra, Luigj Shyti, Zef Gjeta dhe unë, si dhe dy libra botim i shoqatës. Gjithashtu ne, e falënderuam Institucionin e Presidencës për vlerësimin e figurave dukagjinase duke filluar që nga Presidenti Moisiu, Presidenti Topi dhe për vlerësimin që ky së fundmi Mehmet Shpendin e nderoi veprën e tij, me urdhrin "Nderi i Kombit". Ai ndjeu kënaqësi që u takua me ne. Na falënderoi dhe ne, për punën që bëjmë, në veçanti që jemi vetëm vullnetar. Nga kjo kënaqësi që pati, mori nismën që ne, në pranverën të vitit të ardhshme, 2016 të zhvillojmë një veprimtari kulturore e artistike në Pallatin e Brigadave. Për ne është vërtetë një vlerësim e kuraja e veçante që na u bë dhe për këtë e falënderuam në mënyrë të veçante.

**Së gjashti**, në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, me datën 10 dhjetor, në bashkëpunim me anëtarët e grupimit "Aleanca për Jetën", në shëtitoren para hotel "Colosseo" u zhvillua një veprimtari e ndjeshmërisë për kundër dhunës e vrasjes.

**Së teti**, jo për nga koha e planifikimit dhe rëndësia, por sepse është një diçka e veçante, ishte realizimi i nismës për ndërtimin, vendosjen dhe përuarimin e dy monumenteve, atë të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe atë të albanologut Martin Camaj. E kemi trajtuar disa here punën që është bere për të nxjerrë lejen e ndërtimit dhe vendosjes së tyre, por gjithsesi duhet theksuar përsëri, sepse është një eksperience e pashlyeshme në kujtesën dhe punën tone në të ardhmen.

Për të marre lejen, u bë gjithçka ishte e mundur. U deshën plote 14 muaj. Me anëtarin e kryesisë së Shoqatës e anëtari i këshillit të bashkisë së qytetit Shkodër, Mhill Prronin, u ulem te bar-restorant "Idromeno" dhe u morën firmat e 25 këshilltareve, duke filluar që nga kryetari i këshillit të bashkisë, av. Bardhyl Lohja,

sepse vetëm në këtë mënyrë behej fakt i kryer miratimi i propozimit tone. Procedurat e tjera ishin formale, por patjetër edhe ato deshën kohen e tyre. Këtë mund ta bënte Mhilli me atë dashamirësinë e tij, që kishte me këshilltarët pa llogarite se kujt force politike ishin. Pastaj u desh puna e debati i disahershëm me Kryetarin e Bashkisë, Lorenc Luken, që më në fund u dha miratimi në parim. U bë kjo, por ç'fare duhej tjetër? A mund të ndërtoheshin këto dy monumente pa fondin përkatës? Kurrsesi jo. Atëherë u bë thirrja kudo menduam se mund të kontribuohet. Në Nju-Jork, nëpërmjet kolegut tim, Mark Dreni; në Miçigan nëpërmjet anëtarit të shoqatës sonë, Ndue Ftonit dhe kryetarit të shoqatës "Dukagjini" në Miçigan, Nikolin Shyti; në Belgjikë nëpërmjet Leke Gilaj, në Zvicër nëpërmjet Kole Çardakut, në Tirane e në Shkodër nëpërmjet shoqërisë sonë, Martin Martini dhe Gjon Dukilaj. E gjithë kjo punë beri të mundur të mblidhet fondi përkatës. Personat që kane kontribuar janë publikuar në gazetën nr. 145, pa dhënë sasinë e kontributit person për person, por në përqindje sipas bashkësive kontribuuese. Për të gjithë ju jemi shume mirënjohës aq sa nuk gjejmë fjale të shprehim mirënjohjen ndaj tyre, por gjithsesi historia do të shkruaj për ta, për këtë kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm material, por mbi të gjitha mbështetja morale të cilët na dhanë, që ne të punonim me vendosmëri në realizimin e nismës sonë. Nga realizimi i kësaj nisme duhet theksuar:

**a)** Edhe një here prezantuam para opinionit qytetar e shtetërorë solidaritetin dukagjinase të trashëguar në shekuj. Në qofte se nuk do të ishte ky solidaritet, nuk mund të mblidhej fondi përkatës dhe as nuk mund të mendohej të ndërtoheshin këto monumente. Prandaj, mbështetja që na kane bere është e pakufishme dhe nuk gjejmë fjale për ti falënderuar.

**b)** Treguam para të tjerëve përgjegjësinë e atdhetare e intelektualeve të anëtarëve të shoqatës sonë në marrjen e nismave të tilla me vlera nacionale.

**c)** Treguam, se sa të vendosur jemi, sa të përgjegjshëm jemi për detyrat që marrim në mënyrë vullnetare, për ti bere realitet ato dhe sa e vendosur e përkushtuar është shoqata e jone në realizimin e misionit të saj.

**d)** Realizimi i kësaj nisme tregon edhe njëherë domosdoshmërinë e krijimit të kësaj shoqate për bashkësinë dukagjinase, e cila gjithnjë e më shume duhet të forcohet e të eci përpara, sepse misioni i shoqatës është, po të thuash i pafund ... Detyra të tjera na presin dhe që patjetër kërkojnë punën tone të pakursyer, por asnjëherë punën tone me kushte. Le të ketë debate, por asnjëherë nuk duhet të japim ultimatume, sepse Dukagjini është i të gjithëve. Askush nuk e ka më gjë se tjetri Dukagjinin tone.

**e)** Kjo përvojë na mësojë, se secili nga ne, është i domosdoshëm në realizimin e misionit të shoqatës, pavarësisht ndonjë problemi të vogël në mes nesh, që është dhe duhet të jete i përkohshëm dhe i kalueshëm, të shikojmë secili më mire punën që bën ne dobi të saj. Sigurisht nuk jemi të prere të gjithë me një gërshtë, se as në familje nuk jemi të tilla. Pra, të jemi më tolerant, më të kuptueshëm me njeri-tjetrin, në veçanti kur nuk ka qëllime dashakeqe apo shfrytëzim të punës e përpjekjeve të tjetrit.

**f)** Duke u nise nga realizimi i kësaj nisme, kemi të drejtën morale, që të ftojme dukagjinasi, në veçanti brezin e ri, të bëhen pjese e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", sepse secili do ta gjeje veten më së miri.

\*\*\*

Duke u nisur nga përvoja e ftuar, Kryesia e Shoqatës, në mbledhjen e saj, me datën 2 dhjetor 2015, miratoi Planin e Veprimtarive të Shoqatës për vitin 2016, si më poshtë:

1. Të vijoje botimi i gazetës "Dukagjini", me këtë përkushtim dhe të pandërprerë në çdo muaj, duke synuar ne rritjen e nivelit të saj ...

Në çdo muaj, redaksia e gazetës

2. Të marrim pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë -2016", në Kosove, e organizuar nga Shoqata "Martin Dreshaj"

Në muaj prill 2016, Seksioni i veprimtarive dhe i kulturës

3. Përgatitja e zhvillimi i veprimtarisë kulturore e artistike në Pallatin e Brigadave, me nismën e Presidentit të Republikës, zoti Bujar Nishani ...

Në muajin maj-qershor 2016, seksioni i veprimtarive dhe i kulturës-artistike

4. Botimi i librit "Dukagjini ne rrjedhat e historisë nr. 3 e 4". Brenda muajit shtator 2016, Redaksia e seksioni në marrëdhënie me publikun

5. Një ekskursion në vendet historike të zonës sonë, në zonën e Dukagjinit, me student të fushave të ndryshme, me një grup të përzier, me përbërje nga 10 deri në 15 vete.

Brenda muajit gusht-shtator 2016, seksioni i veprimtarive të shoqatës

6. Mund të zhvillohen veprimtari të shkëputura, që do të vlerësojë Kryesia e Shoqatës ...

Gjate vitit, Kryesia

\*\*\*

Besojmë në përgjegjësinë dhe në përkushtimin e anëtarëve të shoqatës, të anëtarëve të Këshillit dhe në Kryesinë e saj, Plani i Veprimtarive për vitin 2016 do të realizohet.

**NDUE SANAJ,**  
Kryetari i Shoqatës  
"Atdhetare-Dukagjini"

# Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani, pret në Presidencë përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Ditën e mërkurë, më 17 Nëntor 2015, në Presidencë u zhvillua një pritje, ku Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Bujar NISHANI, priti një përfaqësi të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Objekti kryesor i takimit ishte falenderimi dhe mirënjohja që Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe gjithë zona dëshironte ti shprehte Presidentit të Republikës në lidhje me vlerësimin e disa figurave dukagjinase. Por, takimi ishte mjaft i ngrohtë, frutdhënës dhe mjaft më i zgjeruar sesa objekti në fjalë.

Në takim ishin të pranishëm, nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini": Ndue SANAJ (Kryetar), Gjergj LEQEJZA (nënkryetar) dhe anëtarët Znj. Roza PJETRI, Zef LULASHI, Zef BARI, Lazer STANI dhe Zef GJETA, ndërsa nga Presidenca, Shkëlqesia e Tij Bujar NISHANI dhe 4 anëtarë të kabinetit të tij. Pas ceremonisë së rastit, dhe shkëmbimeve zyrtare të përshëndet-

tjeve, takimi mori nota të një bisede të përzemërt dhe shumë miqësore.

Kyetary i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" Ndue SANAJ, duke falenderuar Presidentin për vlerësimet që ai ka bërë për figurat e Dukagjinit, i dhuroi atij logon e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me dedikimin: "Në shenjë respekti e mirënjohje për vlerësimin dhe promovimin që i keni bërë figurave të zonës së Dukagjinit, për kontributin e tyre në çështjen shqiptare." Presidenti i Republikës, Zoti Bujar NISHANI, e mirëpriti këtë dhuratë, u shpreh shumë i emocionuar dhe i vlerësuar që Shoqata Atdhetare "Dukagjini" e kishte çmuar e vlerësuar veprimtarinë e Presidentit. Ndërkohë që Presidentit iu dhuroi edhe një kostum karakteristik i zonës (tirq, xhamadan e qeleshe), si dhe një set me libra të shkruara nga dukagjinat, studiues të fushave të ndryshme.

Më tej, takimi vazhdoi me një bash-

këbisedim frutdhënës, ku u evokuan traditat e Dukagjinit dhe të dukagjinave, vlerat dhe potencialet që paraqiten, por edhe u sugjeruan rrugë e mundësi për të ardhmen. U diskutua për çështjen e pazgjidhur të rrugës automobilistike, të vlerave historike të luftërave të zhvilluara, por edhe të hershmërisë së banimit të zonës, të vlerave të paarritshme e të pazëvendësueshme të xhubletës e të kangës "maja krahut", traditës së ndërimit të shtëpive e të selitjes së kopshtieve, si dhe të gurë e dru gdhëndies, qëndismave, punës së dorës, e te tjera. si dhe të pasqyrimin të tyre në media, në libra e në studime të ndryshme. Poashtu, u cekën edhe çështjet e zhvillimit të llojeve të ndryshme të turizmit. Në diskutim u përfshinë të gjithë të pranishmit, si nga ana e stafit të Presidencës ashtu edhe përfaqësuesit e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Lajtmotivi i bisedës ishte që

Dukagjini është pjesë e së tërës: e Dukagjinit, e Shkodrës, e Shqipërisë dhe e shqiptarëve kudo që janë. Porse, nevoja imediate shihet në bërje të njohur të këtyre vlerave për një publik sa më të gjerë rajonal, por edhe më gjerë: ndërkombëtar.

Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Bujar NISHANI, propozoi që bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve: Presidencës dhe Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të vazhdojë edhe më tej. Një propozim konkret kishte të bente me një takim të përbashkët që do të zhvillohet në të ardhmen, sugjeruar si "Dita e Dukagjinit", ku të jetë një ditë e organizuar me veprimtari të ndryshme, kushtuar kësaj zone dhe promovimit e njohjes së këtyre vlerave nga të tjerët, në Pallatin e Brigadave, në pranverën e vitit të ardhshëm.

Përgatitë nga Prof.as.dr. ZEF GJETA

## GOXO QË TË FITOSH

PROMOVOHET ROMANI "GUXO" I SHKRIMTARIT FADIL KRAJA, KUSHTUAR BIZNESMENIT TË SUKSESSHËM SHQIPTARO-AMERIKAN NDUE FTONI

Në prag të festave të Nëntorit, në ambientet e bibliotekës "Marin Barleti" të qytetit të Shkodrës, Shoqata "Atdhetare Dukagjini" dhe Shoqata e Shkrimtarëve Shkodër, organizuan promovimin e romanit me titull "Guxo", të autorit Fadil Kraja.

Romani "Guxo", që pasqyron Sagën e një djaloshi shoshjan, mban firmën e dramaturgut dhe shkrimtarit të shquar Fadil Kraja "Mjeshtër i Madh", i cili u paraqit në këtë veepër të re, para një auditori të ndryshëm nga herët e tjera, ku përveç kolegëve, merrnin pjesë edhe shumë miq e dashamir të z. Ndue Ftoni që kishte ardhur nga Amerika, për të qenë të pranishëm në këtë eveniment.

Z. Ndue Ftoni ka lindur në Shosh të Dukagjinit dhe si shumë bashkatdhetar të tjerë, emigroi në Amerikë, ku falë aftësive të tij intelektuale, guxoi të integrohej në jetën e zhurmshme amerikane, ku ndërtoi "një varkë" që i përballoi të gjitha tallazet dhe furtunat, duke u bërë kështu një shembull për të gjithë bashkatdhetarët e vet, jo vetëm si një biznesmen i suksesshëm, por edhe si një "mecenat" për të gjithë artistët dhe këngëtarët me origjinë shqiptarë që jetojnë në Amerikë.

Këtë veprimtari, këtë guxim, pasqyron në librin e tij "Guxo" shkrimtari i shquar Fadil Kraja, ku një pjesë të kësaj veprimtarie të suksesshme ai e pa me sytë e tij dhe e përjetoi vetë në udhëtimin e tij në Amerikë, ku ishte dhe mik i nderuar i z. Ndue Ftoni.

Nën prezantimin e moderators-aktorese së teatrit "Migjeni", Rajmonda Marku, për vlerat e romanit e të autorit ligjërues redaktori i veprës e njëkohësisht kryetar i shoqatës atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, autori i parathënies, poeti e publicisti Prelë Milani, kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës, Skënder Temali, kritiku letrar-Kadri Ujka, studiuesja Arjeta Ferlushkaj, psikologjia Suela Ndoja e te tjerë.

Aktorja e teatrit "Migjeni", Rajmonda Marku në prezantimin e këtij takimi tha: "Këtë libër autori ia ka kushtuar z. Ndue Ftonit, një trashëgimtar të denjë të banorëve alpinë, i cili me shumë vullnet, me shumë dinjitet ka arritur të krijojë personalitetin e tij jashtë trojeve shqiptare, në Amerikë, si një biznesmen i suksesshëm, por edhe si një njeri human me vlera atdhetare...njeri nga miqtë me të mirë të artistëve shkodranë e jo vetëm, i cili ka dhënë pa ndërprerje ndihmën e tij bujare për t'i prezantuar ata me artin e tyre para bashkëkombësve tanë në Amerikë. Unë jam një prej shumë artistëve të ftuar prej tij, në aktivitete të bukura që ai organizon në Detroit e pikërisht në "The Imperial House" që e drejton me shumë sukses. Konsideratë për te dhe familjen e tij, znj. File e fëmijët e për mikpritjen e veçantë. Suksese në jetën dhe punën e tyre!"

Nga Anglia, anëtarja më e re e shoqatës së shkrimtarëve të Shkodrës, Amina Meshnuni, e cila studion atje, i kishte dërguar Mjeshtër Kraja një tufë me lule të freskëta.

Impresion solli para auditorit prania dhe fjala që ai mbajti, e cila u ndërpre disa herë nga duartrokitjet e të pranishmëve.

Vetë Ndue Ftoni i pranishëm në promovimin e romanit që i kushtohet atij dha disa mesazhe.

"Ka njëzet vite që unë jam larguar nga vendi im. Lot, mall, djersë, mund, pare, humbje, fitore. Është e njëzet e pesta herë që unë vij nga Amerika në vendlindjen time, e cila nuk ka mundur të ma mposhtë shpirtin të cilin për dyzet vite i kam kaluar me ju. Amerika me më dhanë tërë pasurinë e saj nuk mundet të ma barazojë me pasurinë që kam lënë këtu në Shqipëri. Ju jeni ata që peshoni në vendi tuaj, fëmijët tanë nuk mund të jenë shqiptarë të denjë ashtu siç jemi ne, por është detyra jonë

që ata t'i rrisim me dashuri për atdheun, për vendin e të parëve".

Në fund u dëgjua me interes dhe përshëndetja e shkrimtarit Fadil Kraja, i cili edhe nënkroi autografe për romanet e dhuruara.

E veçanta e këtij "romani", qëndron në atë, që prof. Fadil Kraja shpesh e ka thënë... Pse nuk shkruajmë për njerëzit sa janë gjallë, por vetëm kur ata nuk jetojnë më!? Këtë ide, ka kohe që ky shkrimtar i madh e ka vënë në jetë.

Para pak kohësh shkroi për futbollistin e madh, Ramazan Rragami, shkroi për femrat shkodrane që po bëjnë emër në jetën shkodrane dhe më gjerë, e të tjera e të tjera.

Edhe në këtë roman, personazhi kryesor është një djalos, që u bë një figurë e njohur, një dukagjinat i njohur dhe ndër të rrallët si njeri dhe nga vepra e tij.

Është shumë i dashur, i respektuar, largpamës, i guximshëm, bujar, madje sikur bujaria ka lindur së bashku me te.

Personazhet e Krajës janë gjallë dhe vijojnë të kontribuojnë, vijojnë të kenë suksese gjithnjë në rritje, siç është rasti i biznesmenit të njohur Ndue Ftoni. Por e veçanta e Ndojës nuk vjen nga hiçi. Ai vjen nga puna e pa ndalur. Ai është një biznesmen i suksesshëm në shtetin e Miçiganit në SHBA!

Kjo ikonë e letërsisë shqipe di ku t'i gjej heronjtë e veprave të tij.

Në gjurmët e Fishtës, në kullat e Dukagjinit dhe të Malësisë, në të gjithë hapësirën shkodrane, aty ku janë shkruar faqet me të lavdishme të historisë epike dhe sociale të këtij qyteti.

Në mbyllje të këtij takimi, në "Grand Hotel Evropa", Ndue Ftoni shtroi një koktej për të pranishmit.

I gjithë aktiviteti ku morën pjesë edhe artistë të shquar nga Shqipëria dhe Kosova u regjistrua nga kamerat e stacioneve televizive

lokale e kombëtare, por edhe nga vetë televizioni ACTV në Miçigan që është pronë e z. Ndue Ftoni, në mënyrë që ky përrim të publikohet edhe në SHBA.

Vetë z. Ndue Ftoni u largua nga atdheu me mbresa të jashtëzakonshme, me frymëzimin dhe vitalitetin e tij që e karakterizon, për ta përcuar këtë atmosferë vëllazërore mes bashkatdhetarëve të tij në Amerikë, i përgatitur për të festuar festat e fund vitit me ta, ashtu siç u festua Dita e Flamurit në "Imperial House", por që gjatë festimit dukej sikur po festohej në Shqipëri.

Gjatë ceremonisë festive me 28 Nëntor 2015 pata fatin të isha i pranishëm edhe unë atje, me ftesën e tij dhe ta përjetoi këtë atmosferë patriotike, emocionale, të cilën nuk do ta harroj kurrë

Ramazan Çeka, Dhjetor 2015



Ndue Ftoni

# Heroi i Popullit, Dedë Gjon Luli

## NDEROHET NË KRYEQYTETIN E SHQIPËRISË

Me datën 27 nëntor 2015, një dite para 103 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ose një dite para Ditës së Flamurit, në orën 11.00 u përurua monumenti i Heroit të Popullit, Dede Gjon Luli. Vërtetë një krenari e veçante, që pas 100 vitesh të rënies së këtij tribune të lirisë, te vendoset përjetësisht në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, në kryeqytetin e shtetit Ate, Tiranë.

Në përurimin e këtij monumenti morën pjesë shumë personalitete vendore të bashkisë së Tiranës, Kryetari i kështillit të Bashkisë Adrian Dalipi, deputet, ministra, kështilltari i Presidentit, Flamur Gashi, malësorë në të dy anët e kufirit, që nga Nju-Jorku e Miçigani, të cilët ishin organizatorët e gjithë punës së bere dhe ceremoninë e të kësaj veprimtarie me përmasa nacionale. Kishin ardhur edhe nga Shoqata "Martin Dreshaj". Frasher Racaj, Ali Tahiri, nga familja e Adem Jasharit e të tjerë. Ishte dhe Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj.

Monumenti ishte vendosur pranë godinës së Muzeut Kombëtar, në anën jug-perëndimore të saj.

Pas zbulimit të shtatores së Dede Gjon Luli, në mjediset e Muzeut, u mbajt një Simpozium shkencor, me temë "Dedë Gjon Luli dhe Malësia e Madhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare".

Pas fjalës së hapjes së Simpoziumit, nga Anton Lulegjuraj, i cili në mes të tjerave theksoi: "Sot, është një ditë e veçantë për të gjithë ne, ditë që na sjellë pas në kohë, por që ngjallë shpresë; ditë kur heroi i popullit Dedë Gjon Luli fiton pavdekësinë duke u ngritur në altarin e qëndrësës heroike në Kryeqytetin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Duke u dekoruar me urdhrin më të lartë të Shtetit shqiptar – Urdhri i Flamurit Kombëtar. Kur armiku tentoi të zhdukte emrin, veprën dhe varrin, ishte koha ajo që nuk lejoi, por që duhej të kalonin plotë 100 vjet nga rënia e Dedës në mënyrë që në Tiranë të ngrihej në Lapidar. Ishte në moshë, por etja për liri e rinonte deri në atë masë sa që kishte kaluar të shtatëdhjetat dhe mori përsipër barrën kryesore duke u bërë udhëheqësi suprem i Kryengritjes së Malësisë të 6 prillit të vitit 1911 ku kulmoi me ngritjen e Flamurit Kombëtar në Bratilë të Deçiqit. Ishte ngjarja më unike, pararendëse e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ai është i gjallë. Ai sot fiton pavdekësinë, përjetësinë, por nuk pushon ende i qetë, për arsye se nuk u realizua plotësisht ëndrra e Tij dhe e bashkëkohësve të tij për të parë Shqipërinë Etnike. Ruajta e tërësisë së çështjes shqiptare, me gjithë përcaktimet e tashme të pjeshme të saj, paraqet detyrë mbi detyrat tona kombëtare. Në kaluam 103 vjet sfidash të kohës, që nganjëherë janë shndërruar

në furtuna shfarosëse, të cilat e sfiduan vetë kauzën tonë. Gati 103 vjet prej Pavarësisë së Shqipërisë, shqiptarët e kanë shtetin që përfshin më pak se gjysmën e popullit shqiptar në Ballkan dhe më pak se gjysmën e territorit. Jemi në prag të 103 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë



dhe në të njëjtën kohë ballafaqohemi me realitetin e hidhur të Konferencës së Londrës! Për një shekull shqiptarët festojnë 28 nëntorin e ngritjes së Flamurit në Vlorë dhe jo datën e shtetit shqiptar të Konferencës së Londrës të vitit 1913, datë në të cilën Shqipëria do njihet ndërkombëtarisht. Pra, festojmë një ëndërr, e jo një realitet. Me sa duket, kur shqiptarët nuk e kanë atë që pëlqejnë, pëlqejnë atë që kanë dhe ky realitet sikur e "zëvendëson" ëndrrën e tyre! Problemet aktuale të shqiptarëve në Mal të Zi, në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc, të shqiptarëve në Maqedoni apo të atyre në Çamëri, në

pamje të parë tregojnë një vetë – izolim të shtetit shqiptar duke pasur parasysh edhe lobin e fuqishëm të disa shteteve fqinje si Serbia dhe Greqia në këtë vend. Shteti shqiptar do duhej të ishte gardian i shqiptarëve jashtë kufirit administrativ. Shqipëria ka gjithë përgjegjësinë historike për shqiptarët që kanë mbetur jashtë kufirit administrativ.

Objektivi i shqiptarëve duket se po ndryshon. Kjo ndoshta edhe për shkak të trysnisë që bëhet nga vendet fqinje. Sepse nga një objektivi që të kenë një shtet shqiptar, po përballen me objektivin e të bërit pjesë e Evropës së Bashkuar. Mirëpo, ajo rrugë nuk është tërësisht e qartë, kjo për shkak të Kosovës që vazhdon të mbetet peng i Serbisë sa i përket aspiratave të veta Evropiane; shqiptarëve në Mal të Zi po u krijohen përditë kushte për "dëbim kolektiv", pa asnjë lloj perspektive; shqiptarët në Maqedoni të pa unifikuar në çdo aspekt; diaspora shqiptare plotësisht e lënë në mëshirën e fatit, d.m.th. pa asnjë plan strategjik për mundësinë e kthimit dhe investimit të tyre në Atdhe. Mos unifikimi i diplomacisë shqiptare, tregon foshnjën që edhe pas 103 vjetëve është duke u rritur.

Një pyetje tjetër natyreshëm do shtrohej; atëherë, çfarë nuk kemi mësuar ne për këto 103 vite shtet? Teoria Stavileciane e artë e Kosovës do të thoshte: Nuk kemi mësuar:

-Për ndërvarësinë e pjesëve të veçuara të çështjes shqiptare;

-Për domosdoshmërinë e paraqitjes si një komb politik, gjeografik dhe historik;

-Nuk e kemi kuptuar realitetin që na ka rrethuar;

-Nuk e kemi parë të udhës që të bashkëveprojmë për interesa të përbashkëta;

-Jemi ulur në tryeza ndërkombëtare pa u marrë vesh me njëri – tjetrin brenda tryezave kombëtare;

-Nuk kemi kuptuar se pa qenë mirë në Tiranë, nuk do jetë mirë në Prishtinë, as në Shkup as në Tetovë, as në Çamëri as në Plavë e Guci, as në Luginë të Preshevës e as në Ulqin dhe as në Malësi të Madhe.

-Nuk jemi vetëdijësuar se jemi popull i ndarë padrejtësisht. Jemi sjell sikur të ishim gjashtë popuj dhe sikur të kishim gjashtë çështje të ndryshme;

Po atëherë çfarë nuk duhet të harrojmë? Nuk duhet të harrojmë që:

a) Ekzistojnë tre fjalë që fillojnë me të njëjtën shkronjë e që janë të përbashkëta dhe të pandashmet e gjeneve tona: Gjuha, Gjaku dhe Gjeografia, të cilat

mund të mbajnë gjallë identitetin tonë kombëtar;

b) Se hapësira etnike shqiptare është një njësi kombëtare, historike, kulturore, gjuhësore, gjeografike dhe politike.

Dhe kjo nuk duhet të na lejojë që të rritemi si popull dhe të tkurremi si komb, sepse e kemi obligim që të ecim përpara drejt aspiratave kombëtare.

Në nuk kemi vendosur asnjëherë për fatin tonë kombëtar. Gjithëherë të tjerët kanë vendosur për neve. Shqipëria ka nevojë që të kalojë nga një "Demokraci e qeverisur" në "Demokraci qeverisëse" në mënyrë që shqiptarët të mund të flasin për të nesërmen dhe të pasnesërmen.

Sot, edhe pas 103 vjetëve të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, populli shqiptar në Mal të Zi gjendet në një situatë kritike në çdo aspekt të jetës shoqërore. Më kanë pyetur se çfarë kanë të përbashkët Malësia e Madhe (vendlindja ime) dhe Ulqini? Jam përgjigjur: pa aftësinë..., në Ulqin të mbajnë Komunën dhe në Malësi ta themelojnë atë. Më kanë pyetur, po çfarë kanë të përbashkët: Tivari, Rozhaja dhe Plavë e Gucia? Jam përgjigjur: të përbashkët kanë asimilimin, sepse të tre këto vende janë asimiluar për të njëjtin qëllim dhe nga e njëjta politikë, pra po përmbillet akti gjenocidal ...".

\*\*\*

Në Simpozium u mbajtën këto tema:

1. Prof. Dr. Frashër Demaj - Kryengritja e Kosovës 1910 dhe e Malësisë së Madhe 1911; pararendëse e Pavarësisë së Shqipërisë;

2. Prof. Dr. Romeo Gurakuqi - Kryengritja e Malësisë së Madhe dhe 6 prilli i vitit 1911, flamuri kombëtar në Majën e malit Deçiq;

3. Prof. Dr. Marenglen Verli - Memorandumi i Greqës, gurë-themeli i Pavarësisë së Shqipërisë 10-23 qershor 1911;

4. Prof. Dr. Mahir Hoti - Dedë Gjon Luli fytyrë shumë dimensionale;

5. Në bashkë-autorësi nga Dr. Gjovalin Gjeloshi dhe studiues Gjergj Shyti, para jush Gjergj Shyti, me temën: – Dedë Gjon Luli – prijësi legjendar i Malësisë së Madhe, ndera e gjallë e krahinës së vetë;

6. Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti - Jehona e shtypit të kohës për Dedë Gjon Lulin dhe Kryengritjen e Malësisë së Madhe.

Pas simpoziumit u dha një koncert e veçante folklorik ... E veçanta e këtij koncerti ishte kënga "Për Flamur", te kënduar nga Ndue Shytani e Fran Kodra, si dhe një grup polifonik që këndoi një këngë për Dede Gjon Lulin ...

\*\*\*

Në darke, në Presidencë, Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani dekoroi, Heroin e Popullit Dede Gjon Luli, me urdhrin më të lartë, atë të Flamurit Kombëtar.

Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"

# Historik i shkollës Bardhaj

- ME RASTIN E 10 VJETORIT TË SHKOLLËS -

Shkolla e pare fillore në fshatin Bardhaj është hapur në vitin 1945 në godinën Qela Xhakojve në kodër të Bardhanjorve. Kjo shkollë ka përfshirë grupe nxënësish të moshave të ndryshme. Shkolla kishte synim zhdukjen e analfabetizmit në fshat, të mësohej lexim, shkrim dhe veprime të thjeshta matematikore. Mësues të pare në këtë shkollë kane qene Paulin Capaliku dhe Mark Prendi. Në vitin 1947 u ndërta shkolla fillore te "Boka e shkollës" me mësues Mark Prendi, Nuh Shemën e të tjerë. Pranë kësaj shkollë vazhduan mësimet disa breza nxënësish deri në vitin 1961. Në këtë vit shkollor 1961-1962 u ndërta shkolla e re fillore ku është edhe sot si aneks i shkollës 9-vjeçare Bardhaj. Në këtë shkollë kane dhënë dhe vazhdojnë të japin mësim shume emra mësuesish si: Nuh Shema, Izbie Bushati, Teuta Shala, Marta Naraci, Mela Thani, Margarita Ceka, Domenika Boci, Saime Ramadani, Vjollca Gero, Neta Manovi, Vitore Radorina, Vitore Cara, Elektro Haxhija, Leke Pjetri, Ilir Veselaga, Saimira Hyseni, Valbona Bala, Lida Zeka, Aferdita Caka, Rudina Hoti, Vjollca Qehaja, Nora Noga, Age Pjetri, Vaid Sokoli, Fran Beka, Alma Koleci, Mira Kroni, Dalina Arra, Ndue Kamdaci, e të tjerë.

Shkolla 9-vjeçare Bardhaj u hap për here të pare me date 24 nëntor 2005. Drejtori i pare i shkollës është Fatmir Mehja, nëndrejtor Leke Pjetri. Mësues kane qene Kujtim Troshani (gjuhe-letersi), Emerjona Jakupi (matematike), Vjollca Uka (matematike), Tereze Brigja (gjuhe-letersi), Ardiana Alia (bio-kimi), Alfred Zefi (histori-geografi). Me datën 07. 03. 2006, Ditën e mësuesit u be pëdurimi i shkollës 9-vjeçare Bardhaj. Morën pjesë deputeti i zonës, Razim Cobaj; Drejtori i Arsimit, Loro Mandi; Shefi i kuadrit të arsimit, Kol Shiroka, Kryeinspektori i arsimit, Arben Dani; Drejtoresha e shkollës 9 vjeçare "Pashko Vasa", Jolanda Alia. Nga pushteti vendor morën pjesë këshilltaret e komunës, Lic Elezi, Lina Pjetri e Jonuz

Elezi; Sekretari i komunës, Tonin Deda; kryepleqt e fshatit, Ndue Deda e Hajredin Isufi; përfaqësuesit të banoreve të fshatit, Gjon Sterai, Selim Zeqiri, Bajram Hysaj, Bahri Hyseni e të tjerë. Gjithashtu morën pjesë inxhinieri i ndërtimit të shkollës, Faik Curri.

Fjalën e hapjes së pëdurimit të shkollës e mbajti nëndrejtori, Leke Pjetri, i cili pasi përshëndeti mësuesit, nxënësit e banoret e fshatit, ju uroj mirëseardhjen të gjithë të ftuarve. Fjalën përshëndeste e mbajti Drejtori i shkollës, Fatmir Mehja, i

Me këtë rast përshëndeten Drejtori i arsimit, Loro Mandi, Tonin Deda, Ndue Deda e Faik Curri. Pas përshëndetjeve dhe prerjes së shiritit nga Ramiz Cobaj dhe Loro Mandi, u dha një koncert i shkurtër artistik me këngë dhe valle nga nxënësit e shkollës të përgatitur nga mësuesja Vitore Radohina.

Në pëdurimin e shkollës 9-vjeçare Bardhaj, personeli mësim dhënës përbehej: Drejtori, Fatmir Mehja; Nëndrejtori, Leke Pjetri; mesuesit- Kujtim Troshani, Zef Uka, Defrim Cuku, Emirjona Jakupi, Ar-

Shytani, Jetmira Fugarini, Klodjana Brahim, Ditjola Gruemira, Hide Biba, Madalena Lukani, Arben Jubani, Egena Zymeri, Vojsava Perkola, Fatbardha Mani, Arber Shytani, Elton Daniku dhe edukatoret Albana Beqiri dhe Senada Selmani.

Për një periudhe dy vjeçare, detyrën e nëndrejtorit e ka kryer edhe Gjoke Marashi.

Në vitin 2011 shkolla u plotësua me psikologe, Çelestina Mucollari, e cila ka kontribuar për një periudhe 3 vjeçare dhe pastaj u largua dhe vendin e saj e



cili beri një histori të shkurtër të shkollës e arsimit të nxënësve në fshatin Bardhaj, kuadrove që kane dale nga ky fshat në profesione të ndryshme si mësues, oficer, inxhinier, agronom, veteriner e të tjera.

Deputeti i zonës, Ramiz Cobaj, përshëndeti nxënësit, kolektivin e shkollës dhe banoret e fshatit dhe i uroi 7 marsin, godinën e re të shkollës.

djana Alia, Gjon Kosteri, Age Pjetri, Vitore Radohina, Vjollca Uka, Mira Kroni, Dalina Arra, Erlinda Bektashi, Ndue Kamdaci, Nora Noga, Vjollca Qehaja, Alma Koleci.

Në vitin shkollor 2006- e në vazhdim kane dhënë mësim mësuesit: Anton Maci, Andi Kola, Mira Pjetri, Vilson Hal-luni, Albina Nikjari, Sonila Pirani, Mirsada Tepelia, Arben Vila, Valbona Rupa, Brunilda Jubica, Marinela Lejthia, Pashka

ka plotësuar psikologu Arvjo Fishta, i cili vazhdon të japë kontributin e tij pranë shkollës sonë.

Kryetari i pare i bordit të shkollës është Bajram Hysaj, i cili vazhdon ta ushtroje në vijimësi funksionin e tij pranë shkollës sonë.

**Përgatiti, Leke Pjetri, Nëndrejtori i shkollës, 9 vjeçare Bardhaj**

## Në Kosovë ...

Me ftese te drejtuesve te teatrit "Aleksandër Moisiu", me qendër ne Peje, me rastin e 25 vjetorit te themelimit te këtij teatri dhe ne "Ditën e Plisit", ne fshatin Doberdol te komunës Kline, një përfaqësi e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" mori pjesë: Ndue Sanaj, Prele Milani, Zef L. Sokoli, Lulash Brigja dhe Anton Kosteri.

Veprimtaria e 25 vjetorit te themelimit te teatrit "Aleksandër Moisiu" u zhvillua ne Peje, me datën 30 tetor 2015. Ne orën 17. 00, pas hapjes se kësaj veprimtarie, u dha një dokumentar mjaft i mire. Ne fund te veprimtarisë, ne emër te Shoqatës, përshën-



deti, Kryetari Ndue Sanaj. Drejtuesit e Teatrit, shoqatës i dhëne titullin "Mirënjohja e Teatrit Aleksandër Moisiu"

Me datën 31 tetor 2015, ne shkuaam ne Doberdol te Komunës se Klinës. U vendosem ne dhomën e shtëpisë se Zenel

Hasan Berishës, ku do te zhvillohej veprimtaria "Dita e Plisit". Ne ketë dhome u mblohdhëm rreth 70 vete. Veprimtaria drejtohej nga Ismet Berisha Lala dhe



Prend Buxhala. Morën pjesë përfaqësues nga te gjithë hapësirat shqiptare. U mbajtën katër kumtesa, nga Bashkim Lajçi, Migena Arllati, Fahri Xharra dhe Prend Buxhala. Ne ketë veprimtari, ne emër te

Shoqatës përshëndeti anëtari i kryesisë, Prele Milani.

Veprimtaria u mbyll me një dreke te këndshme, dhe me një vizite ne shtëpi-



në e piktorit e Idriz Berishës. Një pritje shume e ngrohte. Pas saj, vizituam studion e punës se piktorit.

**Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"**

# DASHURI E MIRËNJOHJE PËR VENDLINDJEN

BASHKËBISEDIM ME AUTORIN E LIBRIT “DUKAGJINI-SHQIPËRIA IME ATY”, REFLEKSIONE, NDUE SANAJ, KRYETARI I SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Jo në pak raste kemi trajtuar konfliktet e shkaqet e tyre, në veçanti për gjakmarrjen. Madje, me Komisionin Drejtësi e Paqe, në muajin dhjetor 2010 kemi zhvilluar edhe një Simpozium shkencor, me teme “Gjakmarrja retorike apo realitet?”.

Shoqata e jone, nuk ka si objekt trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve, se objekti i saj kryesor është në fushën e historisë dhe kulturës. Ne, gjendjen e çështjeve sociale e shikojmë në raport të drejtë me rolin e shtetit dhe rolin e individit, në raport të drejtë me marrëdhënien njeri me tjetrin, të pashtëpëtur nga njeri-tjetri. Koncepti ynë është, që gjithçka të zgjidhet në raport me shtetin, me strukturat e tij, sepse jo vetëm që kemi SHTET, shtet demokratik, çka do të thotë larg mendimit të një shoqërie primitive, larg drejtimit të shoqërisë me norma primitive, në kohën kur nuk kishim shtet. Çdo konflikt që zgjidhet me vetëgjyqësi, i takon një shoqërie primitive. Ne kemi qene dhe jemi kundra shoqatave të zgjidhjes së konflikteve në baze të metodës së drejtës zakonore, në veçanti të asaj të gjakmarrjes. Shteti i brishtë demokratik, në fillimet e tij, krijoj të gjitha hapësirat për rikthimin e fenomenit të gjakmarrjes që ishte fundosur për 50 vite, në një kohë, që shtrita e persekutuar nuk u ngrit të hakmerrej (vetëm një rast ka qene, qe një i persekutuar mori hak, gjak), kur ne, nuk ishim të pushtuar nga asnjë armik, kur ne nuk kemi pasur, asnjëherë në histori shoqata të pajtimit të Gjakut .... Dhe çudia e madhe ndodhi, kur gjykatat tona, në emër të demokracisë ligjësuar Shoqatën e Pajtit të Gjakut. Madje, na u krijuan shume të tilla, për çdo rreth, për çdo Qark, duke u pagëzuar me emra të ndryshëm, duke pasur edhe në një rreth disa prej tyre, u bashkuan edhe në disa tubime, që i quanin kongrese, arritën edhe të marrin emri Pajtimi Mbarëkombëtar me qendër në Tiranë, të “detyrojnë” të marrin pjesë në këto tubime edhe anëtar të qeverise e deri Presidenti i Republikës, të vene detyra Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe Qeverise, Mediave e Pushtetit Gjyqësor, dhe të lidhen edhe me Sekretarin e OKB-se! Pra, u çuan në këmbë kush e kush të mashtroje më shume e më shume, për të fituar para. Dhe çudia e më e madhe ishte, kur Kuvendi i Shqipërisë, miratoi ligjin nr. 9389, date 4 maj 2005, me teme: “Këshilli koordinues për Luftën kundër Gjakmarrjes, me në krye Presidentin e Republikës”. Është shume interesant se, atë që beri Ahmet Zogu, sipas profesor Ismet Elezi, në librin e tij “Mbi të drejtën zakonore”, në fq. 28 që thekson “... me dekretin e 30 qershorit 1928 (Zogu), për rregullimin e marrëdhënive të caktuara juridike njihte Kanunin e Leke Dukagjinit dhe kanunin e Skënderbeut, si burim të së drejtës në një kohë kur vepronin ligjet e shtetit shqiptar ...”. kur u vete shpall mbret, me 1928, beri dhe Kuvendi ynë, në vitin 2005. Pra, strukturat gjyqësore e ligjësuar gjakmarrjen në Shqipëri e në veçanti në Veri! Kuvendi i Shqipërisë me dekret të veçante e ligjëroi drejtpërsëdrejti gjakmarrjen, duke e kthyer shoqërinë tone, në një shoqëri primitive, në një shoqëri pa shtet!? Kohet e fundit, TV “Top-Channel, Ministria e Arsimit e Shkencës, Avokati i Popullit, janë çuar në këmbë për të mbrojtur këtë fenomen të një shoqërie primitive, në shoqërinë tone. E turpshme është kur, Ministria Nikolli, thotë: “U trishtova shume, kur mora në prehër vajzën e ngjuar ...!” Turp të madh dhe papërgjegjshmëri e konsideroj këtë qëndrim të Ministres sonë të Arsimit. Askush nuk shkon e qanë nevojën e fëmijëve që kane mbetur jetim, sepse ju kane vrare babën!? Askush nuk shkon e qanë nevojën

atyre pleqve që kane mbetur pa përkrahje, sepse ju është vrare djali!? Me datën 14 shtator 2015, lexoi ne gazetën “telegraf”, artikullin “Ministria e Arsimit braktis fëmijët e ngjuar”, me autor Dori Hoxha ..., i cili në mes të tjerave shkruan “... Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla përshëndeti dje shartimin e fillimit të vitit të ri shkollor, por në deklaratën e ministres nuk kishte hapësirë për rreth 35 mije fëmijë të ngjuar në zonat e Veriut. Kjo plage shkollore, e cila privon nga shkollimi një numër të madh fëmijësh ende nuk ka marre një zgjidhje konkrete nga Ministria e Arsimit dhe Qeveria. Prej 25 vitesh ...”. Apo, me datën 15 shtator 2015, po në këtë gazete shkruhet “Disa të rinj në Shkodër kanë shfrytëzuar dje ditën e parë të shkollës për të protestuar kundër gjakmarrjes. Qytetarë të Shkodrës, të rinj të operacionit “Colomba” nga “Korpusi i Paqes në komunitetin Papa Giovanni 23”, u mblodhën në qendër të qytetit, pasi 18 fëmijë në këtë zonë nuk mund të ndjekin dot shkollën si bashkëmohatarët e tyre për shkak të gjakmarrjes. ... Deri më tani nuk ka ende shifra zyrtare se sa është në total numri i shqiptarëve që vuajnë nga hasmëria, por bëhet publike që nga ky fenomen janë vrarë rreth 900 persona. Edhe pse kanë kaluar me qindra vite nga koha e Kanunit, gjakmarrja vijon të jetë prezentë.” Nuk e di se si mashtrohet kaq shume, kaq hapet dhe askush nuk ndalet për ti thënë stop kësaj gjendje diskriminuese për shqiptaret në tërësi dhe për veriorët në veçanti.

Te ne, në shoqërinë tone, konflikti i gjakmarrjes është kthyer në Mafie! Pra, zoti Kadri, zgjidhja e konflikteve po behet zgjidhje në baze të drejtave zakonore të një shoqërie primitive, dhe jo në baze të ligjeve të shtetit demokratik. Ne, jemi me atë, qe menjëherë çdo dekret apo ligj, që është nxjerre nga Kuvendi i Shqipërisë për gjakmarrje të shfuqizohet dhe bashke me to edhe ato shoqata, pavarësisht nga emri, qofte krijuar brenda vendit apo që kane ardhur nga jashtë, të shfuqizohen. Ne, jemi për zgjidhjen e konflikteve dhe deri te konflikti i gjakmarrjes, në baze të ligjeve të shtetit demokratik. Çdo vetëgjyqësi, për ne, është i papranueshëm dhe e dënueshme, e dënojmë me forcën më të madhe. Për këtë jemi dhe do të jemi. Besoj se është e tepërt komentimi mëtejshëm.

**Z. Sanaj, thonë libri, për autorin, i ngjan një fëmijë të ardhur në jetë. Ju lutem dy fjalë si lindi ideja e ardhjes në jetë të librit tuaj “Dukagjini-Shqipëria ime aty”?**

Po, e dua këtë libër shume. Ky libër nuk ka një teme studimi apo krijimtarie të veçante. Nuk është monografi, histori e veçante, tregime apo roman e të tjera gjini të letrave. Është një përmbledhje artikujve të mi, të botuar me shume modesti në gazetën tone të shtrenjte e pagëzuar me emrin “Dukagjini”. E dua shume dhe mendoj këtë ‘djallë’ ta bej me motra apo vëllezër të tjerë, duke i botuar edhe ndonjë studim, ndoshta kujtime të mia, ndoshta historinë familjare ... dhe si më i ‘madh’, të drejtoje të tjerët, të mbështetem në te ...

Dukagjini është pjesë e hapësirës së Republikës së Shqipërisë, është pjesë e hapësirës së nacionalitetit shqiptar. Në këtë hapësirë ka vendin e vet gjeografikisht dhe me kontribute të ndjeshme dhe që janë pjesë e themelit të shqiptarisë, duke dhënë atë kontribut modest si çdo pjesë tjetër e shqiptarisë. Pra, traditat shqiptare janë dhe tradita të dukagjinave, e asgjë nuk e shkëput nga shqiptaria. Prandaj i kam pagëzuar me atë emër, Dukagjini-Shqipëria ime aty.

**Z. Sanaj! Si ushtarak karriere patjetër keni njohur më nga afër mbështetjen e shtetit shqiptar lidhur me planin për Çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb. Vërtet ka ekzistuar ndonjë njësi ushtarake me këtë motiv, nga viti 1980?**

Po, ka ekzistuar Plani për Çlirimin e Kosovës. Në këtë kohë kam qene Komandant i Brigadës së Këmbësorisë në Has, me qendër në Krume, në përbërje të Korpusit, me qendër në Puke. Kishim mbështetjen e mundshme të shtetit Shqiptar e në veçanti të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Disa here në vit, një nga kuadrot kryesor bënte vizite në brezin e Brigadës, Drejtori i Drejtorisë Operative, Kiço Mustaqe; Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Veli Llaka; Z/Ministri i Mbrojtjes, Maliq Sadushi, e të tjerë. Vete, Kadri Hazbiu, në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes nga viti 1980 e deri në vitin 1982, çdo vit vinte dy deri tre here, në brezin e mbrojtjes së Brigadës së Tropojës, të Hasit dhe të Kukësit, i cili shikonte punën që kishim bere, na dëgjonte me vëmendje për punën që kishim bere, për problemet që kishim, mendimet tona për zgjidhjen e tyre dhe pastaj na jepte udhëzime e detyra për zgjidhjen e problemeve dhe forcimin e gatishmërisë luftarake në mbrojtje të kufijve të vendit.

Me lejoni tu jap dy shembuj:

**I pari,** ishte muaji tetor 1979, kur më vjen në brigadë N/Drejtori i Prapavijave të Ushtrisë, Arshi Dodaj së bashku me z/Shefin e Prapavijës së Korpusit në Puke, SHEME TAHIRI. Erdhën, pasi kishin pare e studiuar projektplanin financiar e ndërtimorë apo buxhetin që i thonë sot, për vitin 1980. Ai, buxheti ju ishte duke shume i fryre. Atëherë, vine në brigadë për ta pare gjendjen drejtpërsëdrejti. Megjithatë vjen me këmbë të pare duke me thënë “A jetoni me situatën?”. I them, shoku N/Drejtor sa ju në Tiranë jetojmë me situatën edhe ne, këtej në Has! Po dua të pyes edhe unë “Ke qene ndonjëherë në Has?” Jo, më thotë. Atëherë, të dalim e shohim një nga një objektet dhe gjendjen e jetesës së efektivit ... Dolëm dhe kur u kthym, më kërkoi falje dhe tha se ju jeni ‘heroi’. Në këtë kohë, brigada kishte në përbërje 12 batalione e grupe artilerie, përveç kompanive autonome dhe që ishin garnizone më vete. Nga 16 garnizone, 11 prej tyre, efektivat jetonin në ndërtesa të mbuluar me llamarine dhe pa tavan... Për dy vjet, në mesin e vitit 1982 të gjithë garnizonet ishin në godina të reja, me kushte jetese normale për kohen, dhe me ndërlidhje nëntokësore deri në arme roje, 100 %.

**I dyti,** në muajin mars 1980 u zhvillua stërvitja komplekse me gjithë efektivin e saj prej 5 500 vete dhe me gjithë forcat vullnetare dhe rininë shkollore efektivit i Brigadës shkollorë deri në 6 500 vete. Stërvitjen e udhëhiqte komanda e Korpusit, por e ndjekte një ekip i Shtabit të Përgjithshëm, me në krye Drejtorin e Drejtorisë Operative të Ushtrisë, Kiço Mustaqi, i cili me vone u emërua Shefi i Shtabit të Përgjigjem dhe Ministri i Mbrojtjes. Stërvitja vijoje 5 dite pa ndërprerje.

Këto dy momente dhe inspektimet e herëpashershme, jo vetëm në njësinë ku drejtoja, por dhe në njësitë e tjera të Korpusit të Pukës, në mënyrë të veçante edhe në Brigadën e Kukësit dhe të Tropojës, tregonin se diçka ishte planifikuar, por ne nuk dinim gjë. Depot nëntokësore në Gjegjan të Pukës u mbushen me municion, armatim, veshmbathje dhe ushqime për efektivin e një armate, e cila afërsisht ka një efektiv deri në 90 mije vete. Në brezat e mbrojtjes së brigadave të skalionit të pare, siç ishte dhe Brigada e Hasit, që nga muaji prill i çdo viti vendosehin në brezat e mbrojtjes së brigadave një

grup artilerie i kalibrit të madh dhe deri një batalion tankesh. Këto batalione e grupe qëndronin deri në fund të muajit tetor apo në fillimi e muajit nëntor.

Atëherë, nuk është si sot, që dihet gjithçka, edhe sa luge kane Forcat e Armatosura Shqiptare! Atëherë, secili dinte aq sa i takonte dhe në qofte se kërkoi të mësoje mbi atë që të takonte, mund te të vihej pikëpyetja! Ne mendonim, që duke u nisur nga praktika e përgjithshme, që agresionet, luftërat fillojnë në pranverë dhe mbyllen zakonisht në fund të vjeshtës, mendonim se na vijonë në përfundim, që në rast nevojë të mos bënim gjithë atë rrugë të gjate dhe mundet me pasoja, të ishin brenda brezit të mbrojtjes së Brigadës.

Për planin e çlirimit të Kosovës e mësova pasi Veli Llaka e publikoi, me duket rreth vitit 1993, të cilin duhet ta keni lexuar dhe juve. Pra, gjithë ajo kujdesie, gjithë ai inspektim i kuadrove kryesore të ushtrisë, që nga Ministri i Mbrojtjes, ishte për diçka më të madhe, por që sigurisht do të na behej i njohur detyra në kohën e caktuar. Ne duhet të vijonim për tu përgatitur pa ndërprerje dhe me shume seriozitet.

Ishte viti 1981, më duket muaji korrik, në një feste të Kukësit, erdhi Mehmet Shehu. Në mes të tjerave, ju drejtua pjesëmarrësve në miting, që nuk kishe ku të hidhej molla, me këto fjale “A më pranoi të jem komandanti juaj? Një urra e fuqishme sa jehoi i gjithë vendi. Atëherë, me ju trimat e trimëreshat e Kukësit, po qe nevoja brenda 24 orëve hyjmë në Prishtinë! ...”. Vijuan urra-te e fuqishme, të paimagjineshme ... Pra, e besoj plotësisht se ekzistonte ai plan, kur kujtoj këto që ju rrëfeva, i bashkoj bashke dhe nxjerre këtë përfundim, se ai plan ishte më se i vërtetë i bere, në vitet 1980, për çlirimin e Kosovës.

**Shoqata juaj sa ka arritur të jetë prezent në zgjidhjen e problemeve sociale të bashkësisë dukagjinase qoftë ndaj atyre që sot janë banorë të qytetit të Shkodrës, qofte ndaj atij që po aq i nderuar vazhdon jetën normale në vendlindjen e vet?**

Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”, pavarësisht dëshirave që të jete prezent kudo nevojave të bashkësisë dukagjinase në fshatrat e krahinat e Dukagjinit apo në qytetin e Shkodrës, por nuk kemi pasur mundësi, sepse mundësitë e një shoqate vullnetare janë të kufizuara, pasi në statusin tone është historia e kultura. Megjithatë nuk janë lenë pas dore kërkesat tona ndaj strukturave lokale e qendrore, siç ishte bërja problem e rrugës Prekal-Kir, e cila megjithëse nuk është ndërtuar ende, por është objekt i qeverise dhe strukturave të tjera të qarkut Shkodër. Mjaft probleme të kësaj jete të re të dukagjinave është shkruar në gazetën tone dhe shtypin tjetër, janë thënë e thënë problematika ndaj disa qëndrimeve të shkëputura në qytetin e Shkodrës, duke e quajtur dukagjinasin sinonim të së keqes, sinonim të krimin. Edhe për mos mësimin e fëmijëve siç duhet, për mos kryerjen e shërbimit shëndetësor ndaj banoreve vendas e të tjera e të tjera. Por dhe ndaj fenomenit të gjakmarrjes jemi shqetësuar dhe për çdo rast kemi reaguar në median e shkruar dhe atë televizive. Dukagjinasi është shume bujar, shume mikpritës dhe solidar. Ngritja në qytetin e Shkodrës të dy monumenteve, atë të atdhetarit Mehmet Shpendi, që u përrua me datën 16 korrik 2015 dhe atë të albanologut Martin Camaj, që u përrua me datën 15 tetor 2015, vërtetoi më së miri ndjenjën solidarë që ka dukagjinasi. Ato u ngritën vetëm me kontributin e tyre, në një kohë rekord.

Dukagjinasi nuk është shenjt, sepse ai ka një karakter të forte, siç është vendi ku kane lindur dhe janë rritur, ku kane mbijetuar në kushte mjaft të vështira, çka do të thotë se nuk nënshtrohet lehte, siç e duan disa shkodrejnë. Ai ka në vetvete ndjenjën e mbi jetesës, ndjenjën e integritit me çdo kusht, kudo ngre çerdhen e jetesës dhe kjo ndjenje sigurisht i bën xheloz ata që janë të mefshte, të pa zot të përballojnë vështirësitë e jetës. Askujt nuk i ka zënë vendin apo shtëpinë! Askujt nuk i ka dale përpara dhe ti marri djersën tij, në Dukagjin dhe kudo gjetke nuk u krijuan banda, siç u bën përpjekje të krijohen në qytet.

Në një studim të publicistit, historianit e poetit, Prele Milanit, në vitet 1774-1909, në një periudhë 162 vjet, në këtë hapësirë që i thonë Dukagjin, janë vrare 162 vete, për gjakmarrje dhe jo për gjakmarrje. Ndërsa në 22 vite të demokracisë janë vrare 145 vete, në mes tyre 15 femra, për gjakmarrje dhe jo për gjakmarrje. Po, të ishte luftë frontale nuk do të ishin vrare kaq njerëz në këtë hapësirë. Pse kane ndodhur këto vrasje? Kane ndodhur se, shteti më duket donte të kishte anarki për të lodruar më mire në qëllimet e veta për të drejtuar këtë vend me metoda anarkiste.

Besoju, me punën tone historike, me botimet tona, me gazetën tone, me veprimtaritë përkujtimore e shkencore, me veprimtaritë artistike e kulturore, se kemi kontribuar sadopak në edukimin e bashkësisë me ndjenjën, se jemi tashme shoqëri e hapur, në themel së cilës janë vlerat e individit. Pavarësisht vendit ku jeton, ku punon dhe çdo bashkësi kemi pas dhe kemi çfarë ti marrim dhe çfarë ti japim, që të jetojmë së bashku në harmoni e pikësynime drejt së ardhmes euroatlantike.

**Bashkëpunëtorët tuaj janë të shumtë: Kujtoj këtu nga Prof. As. Dr. Ahmet Osja, Mjeshtër i Madh; Prof. Fadil Kraja, Mjeshtër i Madh; Lazër Stani, shkrimtar; Mark Bregu, poet dhe publicist, fitues në vitet 70-të i dy çmimeve të para, me poezitë e tij, si tekste këngësh, njërin në anketën muzikore të muajit nëntor dhe tjetrin në Festivalin Kombëtar, në muajin dhjetor, interpretuar nga këngëtari Petrit Lulo, propozuesi tek z. Ramiz Alia, presidenti Republikës në atë kohe, për emrin "Luigj Gurakuqi" Universitetit të Shkodrës; Dashamir Cacaj, botues, prozator dhe poet, ndër poetët e parë shqiptarë që kultivuan hajkun japonez, aktualisht sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës; Agron Luka, studiues i kulturës dhe i historisë së qytetit të Shkodrës si dhe autorin e këtyre radhëve e të tjerë e të tjerë. Cili ka qenë inkurajimi juaj si shoqatë dhe si redaksi i gazetës "Dukagjini" ndaj kontribuuteve të tyre prej altruistësh duke pasqyruar moshën dhe mundësitë tuaja financiare si gazetë, edhe pse e vetmja gazete me konsolidim në rritje në tërë Shkodrën?**

I nderuar Kadri, gjithë këta që theksoni dhe të tjerë kane qene dhe janë mbështetës, kane qene dhe janë kurajues në punën e shoqatës në këto vite. Disave prej tyre, për kontributin e tyre në jetën dukagjinase e në jetën e shoqatës sone, si Mjeshtri Fadil Kraja, Ahmet Osja, profesor dr. Mahir Hoti, Gjergj Perluca, Ndoc Gurashi, prof. Dr. Romeo Gurakuqi e të tjerëve ju është dhënë titulli "Anëtar Nderi i Shoqatës". Suela Ndoja, Dashamir Cacaj, Lazer Stani e të tjerë janë edhe anëtar të shoqatës, kane detyrë të kontribuojnë dhe kane dhënë një kontribut të mire në gjithë jetën e shoqatës, kane dhënë një kontribut të ndjeshëm dhe kontributi i tyre është në themelet e sukseseve të kësaj shoqate. Por, edhe i nderuari Mark Bregu, Agron Luka e të tjerë janë kontribuues, janë dashamires në çdo fushë të jetës së shoqatës, por në veçanti kontribuues në përmbajtjen në rritje dhe në ecurinë e gazetës. Të gjithë i falënderojmë, ju jemi mirënjohës.

Askush nuk mund të eci përpara dhe të ketë suksese, jo më një shoqate pa kontributin e miqve e mikeve te saj. Sukseset tona kane në themel kontributin e këtyre mbështetësve dukagjinas e jo dukagjinas, në Shkodrën tone, në Tirane, në Malësi të Madhe, në Rrafshin e Dukagjinit, në Malësinë Shqiptare në Mal të Zi. Nuk mund të ngrinin dy monumente në një kohe rekord në qytetin e Shkodrës, pa solidaritetin dukagjinas kudondodhur, që në Nju-Jork, në Miçigan, në Belgjike, në Itali, në Tirane e në Shkodër, të cilëve ju jemi shume mirënjohës. Ju jemi shume mirënjohës edhe atyre të pushtetit vendor në Shkodër, si kryetarit të Këshillit të qytetit Shkodër, av. Bardhyl Lohja; Kryetarit të Bashkisë së qytetit Shkodër, zotit Lorenc Luka, kryetarit të komune së Pultit, zotit Sokol Cubi, e të tjerëve që na kane mbështetur, që na kane dhënë kuraja të ecim pa u ndalur dhe i falënderojmë. A kemi më shume nevojë për tu mbështetur me mendime, me kontribute intelektuale e financiare? Po, kemi nevojë dhe ketë e kërkojmë nga intelektualët dukagjinas, shkodrane. Shoqata tani nuk është vetëm e dukagjinasve, por është dhe e shkodraneve, tiranasve e gjithë shqiptareve. Koha është, që ne duhet ta shikojmë pozicionin tone, që të rritet puna e jone në shërbim të vendit.

Me datën 14 nëntor 2015, një përfaqësi e shoqatës, në emër të shoqatës u takua me Presidentin e Republikës, zotin Bujar Nishani. Në mes të tjerave, jo vetëm që shprehu kënaqësinë e takimit, jo vetëm që na falënderoi për punën e bere, por mori nismën që ne, në Pallatin e Brigadave së shpejti të zhvillojmë një veprimtari kulturore e artistike. Sigurisht, Presidentit i jemi mirënjohës për ketë nisem, por kjo është dhe një force, është një kuraja, është dhe një mbështetje e fuqishme për punën tone të mëtejshme. Ketë ka mundësi çdo dukagjinasi të na japi, qofte i thjeshte, qofte intelektual apo biznesmen. Edhe mbreti ka nevojë për një fjale të mire, jo më ne, që punojmë vullnetarisht.

**Mirënjohja jona e të gjithë miqve të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" shkon për mundësorët e përhershëm të gazetës "Dukagjini", duke filluar nga biznesmeni Gjergj Leqejza deri tek miku juaj, bujari aq serioz, biznesmeni në Miçigan, Ndue Ftoni e të tjerë e të tjerë. Mbresat dhe komentet tuaja rreth këtij kontributi?**

Asgjë nuk behet pa para. Edhe gazeta e jone, si çdo veprimtari tjetër nuk është nxjerre pa para, por me para, duke paguar anën teknike të saj. Deri tani janë rreth 185 kontribuues, në mes të tyre veçohen Mhill Perroni, Pal Lera, Gjergj Vocaj, Gjergj Sokoli, SIGMA, Pal Gjollaj e të tjerë, të cilët i falënderojmë dhe ju urojme me faqe të bardhe. Por duke filluar nga muaji janar 2010 shpenzimet për botimin e gazetës i kane marre përsipër zoti Gjergj Leqejza dhe zoti Ndue Ftoni, duke e ndare vitin në dy pjese, gjashte muaj njeri dhe gjashte muaj tjetri. Shoqata, redaksia e gazetës dhe gjithë lexuesit e saj, ju është shume mirënjohës! I urojme me shprehjen popullore: Paçin e dhënçin!

**Z. Sanaj, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja pritet të dalë me romanin, "Guxo!" ..., të cilin ju e kenë lexuar që në dorëshkrim, roman që merr shtypin nga shembulli i shkëlqyer i shoshianit Ndue Ftoni, aktualisht njëri nga biznesmenët, aktualisht nder më të nderuar në Miçigan, shembull i shkëlqyer prej mecenati, ndryshe një nga mundësorët e shumtë të veprimtarive kulturore artistike në Diasporë dhe në Shkodër përfshirë edhe botimin e gazetës "Dukagjini". Ju, si lexues i parë i atij romani, si e sa mendoni se e gjen veten dukagjinasi në atë roman?**

Romani "GUXO!" ... tashme është paraqite dhe është publikuar nëpërmjet një ceremonie të veçantë para publikut, me datën

14 nëntor 2015. Vërtetë pata rastin ta lexoj para se të botohet, për të cilin me nderoj profesor Fadili duke me kërkuar mendimet përkatëse, si dhe për ta redaktuar. Unë bëra përpjekjet e mia, por vendimtari ishte profesori. Në atë roman pavarësisht se i kushtohet një nder dukagjinasit të suksesshëm, në SHBA, në Miçigan, Ndue Ftonit. Këtu e gjene veten çdo dukagjinasi. Siç e kame theksuar më sipër, dukagjinasi ka aftësinë të kap shpejt të rene, të përshtatet së rese dhe të mbijetoje, të integrohet. Kjo ndodhi edhe me Ndue Ftonin. Kjo ndodhi me shume dukagjinas në qytetin e Shkodrës, në rrethinat e tij, në Tirane, në Lezhe, në Kurbin, në Durrës, në vendet e Evropës, në SHBA e kudo që ata kane ngritur çerdhen e tyre të jetës, pas vitit 1990. E veçanta e dyte e këtij romani, është mbyllja shume e veçantë, me një dialog në mes Dashit e Luigjit, që thërret për perspektiven e jetës, për të ardhmen, kur një personazh, Luigji çdo dite ndizte zjarrin neper kullat e fshatit, për të treguar se ato kullat janë aty dhe presin banoret e tyre, me besimin se një dite do të kthehen, sigurisht në mënyrën që kjo zone asnjëherë të mos braktiset.

A kam mendime ndryshe për ketë roman? Po! Kam mendime ndryshe, në veçanti për vendin dhe rolin e banoreve të rinj të qytetit Shkodër. Banoret e rij dukagjinas, malësorë, mirditor apo fusharak, në qytetin e Shkodrës, nuk janë ardhacakë, nuk janë endacake, por banore të rinj të këtij qyteti, me histori të lashte, me kulture të gjere. Këta nuk janë endacake, por njerëz që kane ardhur në qytetin e Shkodrës dhe janë banore të tij, janë njerëz që dinë të mbijetojmë kudo, njerëz që dinë të bëjmë histori, që kane kulture dhe ti prezantojnë kudo me krenari; njerëz që dinë të japim atë që duhet dhënë për të mirën e shqiptarisë. Nuk janë këta, që dogjëm e prenë në Shkodër; nuk janë këta që përdhunuan Shkodrën; nuk janë këta që vodhën Shkodrën; nuk janë këta që thyen, vodhën e dogjën bankën e shtetit; nuk janë këta, që detyruan qytetaret e vjetër të Shkodrës, se nuk dihet sa i trashe ju është bere "ndryshku", të organizojnë ruajtjen e shtëpive, të pallateve, të rrugicave apo të dyqaneve të tyre; nuk janë këta që qytetin e Shkodrës e kthyem në një fshat të Madh të prapambetur!!! Këto ngjarje negative që ndodhen në qytetin tone, Shkodrën pas viteve 1990, duhet i kërkojmë gjetke dhe tu themi emrin që kane. Këto ti kërkojmë te "Kurvëria politike", siç shkruante dikur publicisti, studiuesi e poeti Prele Milani. Ne, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", përfaqësues e dukagjinasve kudo që janë, ditëm të studiomë e të paraqesim në publik historinë e tyre në shekuj, ditëm të mbajmë një gazete pa u ndalur tash 13 vjet, që po del numri 145, fale kontributit vullnetar të anëtarëve të redaksisë së saj dhe financuesit dukagjinas, në veçanti Ndue Ftoni dhe Gjergj Leqejza, që ditëm të organizojmë e të drejtojmë 8 simpoziume shkencore, që ditëm dhe të studiojmë, botojmë e publikojmë mbi 60 libra; dhe tash në fund që ditëm të ngremë në qytetin tone, në monument në bronz atdhetarin Mehmet Shpendi dhe ta sjellim pas 100 vjetëve të rënies së tij, për të qene i përjetshëm; që ditëm të sjellim albanologun Martin Camaj në vendin e vet e të prehet përjetësisht në qytetin tone.

**I nderuar Kadri, ju faleminderit për mundësinë që me dhatë të shpreh këto mendime para lexuesit të gazetës "Dukagjini" e më gjere.**

Ju faleminderit juve, që më pranuat të bej ketë bashkëbisedim.

**Bashkëbiseduesi, Kadriu Ujkaj, Kritik letrare, muaji nëntor 2015**

## 10 DHJETORI - DITA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

«Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri - tjetrit me frymë vël-lazërimi». Neni Nr. 1

Në mbarë botën 10 Dhjetori shënohet si Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, si një përkujtim i përvitshëm i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila u miratua në vitin 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Pak fjalë për Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut. Mbas këtij akti historik, Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, paraqitet, lexohet dhe të shpjegohet, sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukuese, në të gjitha vendet dhe shtetet pa marrë parasysh statusin e tyre politik. Asambleja e Përgjithshme shpalli këtë deklaratë si ideal të përgjithshëm, të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë, të përpiqet që, me anë të mësimit dhe edukimit, të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe që, me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurohej njohja dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre. Në këtë deklaratë spikat universaliteti, karakteri i pandashëm dhe i patjetërsueshëm i të drejtave dhe lirive, i standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut; legjislacioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut; të drejtat e trashëguara; institucionet dhe procedurat për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me këtë rastë Aleanca për Jetën në qytetin e Shkodës, ne Shetitoren e para hotel "Colosseo", me 10 Dhjetor, ditën e enjte, nga orën 16.00 -19.00 organizoi një Manifestim publik, për të manifestuar së bashku angazhimin e saj kundër çdo lloj dhune. Si në shumë veprimtari të tjera gjatë këtyre orëve Shoqatat "Atdhetare-Dukagjini", Ambasadoret e Paqes, Operazione Colomba dhe Eorld Vision dhuruan për të pranishmit nëpërmjet bisedave, lojrave dhe fletpalosjeve mesazhin mbi jetën e cila duhet të dhurohet dhe të respektohet tek çdo njeri. Të binte në sy harmonizimi i moshave dhe profesioneve. Të gjithë shkëmbenin mendimin se si duhet të mbrohet jeta dhe ti them Ndal Dhunes. Edhe pse ishte mjaftë ftohtë dhe frynte erë, dëshira për të ngritur zërin ndaj dhunës dhe për të hedhur hapa të sigurt në dobi të vlersimit të jetës ishte e madhe.

Danjela Pjetri

# Kodi i gjetjes me dinjitet të vetvetes

- DUKE SHFLETUAR ROMANIN "GUXO!...", TË SHKRIMTARIT FADIL KRAJA -

Dashnori i fjalës si vlerë universale, dramaturgu dhe po aq romancier i konfirmuar, "Mjeshtri i Madh", Fadil Kraja, i mirënjohur për prirjen estetike të përjetimit të fatit të njeriut të thjeshtë, vjen kësaj radhe me një mesazh të ri, origjinal dhe po aq intrigues: Kodi i gjetjes me dinjitet të vetvetes, ndryshe Individualizmi, si filozofi, sfida më serioze për njeriun bashkëkohor. Është fjala për romanin më të ri të autorit në fjalë, me titullin sinjifikativ gjykuar nga mesazhi estetiko-filozofik, që përcjell përmes "heroit kryesor", Dash Kolës, një karakter letrar, që u ofrua në studion e shkrimtarit Fadil Kraja, rrjedhojë e impresionëve të mrekullueshme, që pati autori, falë njohjes nga afër, në Detroit të SHBA-ës, me djalin e talentuar të Dukagjinit, ndryshe me sfidat e suksesshme, të kurorëzuar prej tij, në rrugëtimin plot kurajo dhe guxim gjatë jetës, sot qytetarin shqiptaro-amerikan, biznesmenin dhe mecenatin bashkëkohor, zërin shqiptar të frymës vjeneze në shekullin tonë, z. Ndue Ftoni, të cilit edhe i dedikohet romani "Guxo!...", që sot, kemi kënaqësinë ta promovojmë. Nisur nga sensibiliteti maksimal që ka ngjallur prologu dhe epilogu i ardhjes në jetë të këtij romani, falë investimit të përkushtuar të shkrimtarit Fadil Kraja, si mik virtual dhe real i dashnorëve të fjalës si vlerë universale, ndryshe nga pozitat e kritikut letrar, në dekodifikimin estetiko-filozofik të këtij romani, gjykuar nga universaliteti i mesazhit që përcjell, kam preferuar të integroj gjatë kësaj analize kodin e mirënjohur modern, të psikanalizës, me kodin pronist, që mjaftohet kryesisht në vlerat pozitive të veprës, kod i cili po gjen veten përditë e më shumë në SHBA-ës, si një përvojë e re, sa i takon vështrimin kritik të vlerave estetike, në letërsinë bashkëkohore amerikane. Njëherësh ndjeshmëria maksimale ndaj përcjelljes estetike të karaktereve reale si: Gjoni i Brazhdës, ish-partizani me mustaqe të gjata, me një autoritet moral të lindur, tek i cili spikat një inteligjencë e jashtëzakonshme, sa arrin të neutralizojë gjithë dinjitet "të keqen", reagimin e ashpër të sekretarit të partisë, Gjeloshit: "E, ti more këlysh dhelpre, se dhelpër ka qenë gjithmonë yt at, ku e gjete këtë palavinë vjershe?!?" i drejtohet Gjeloshi nxënësit të talentuar, Dash Kola, i cili, sipas sekretarit të partisë, në vjershën që recitoi evidentonte fjalën "Zot", kur ne ishim shpallur vendi i vetëm ateist në botë. Barrë të rëndë ke, o Gjelosh, se je burrë i mirë, por ma të mirë e ke pas babën. Mos e bëj mizën buall", - i drejtohet Gjoni, gjithë bonses duke dalë në krah të më të pambrojturit të pafajshëm, Dash Kolës. Balë Marku, dukagjinasi babaxhan, brenda të cilit gjente veten njëherësh aq mirë kuptimi i fjalëve edhe shok edhe zotëri, ndryshe njeriu që nderohej deri në kult, aq sa emri Balë për shumë vite në Dukagjin kishte përmbajtjen e respektit dhe të autoritetit. Mushak Deda një figurë, nga më populloret, shakaxhiu që me fjalën e tij të peshuar vriste larg, gjithë intuitë prej malësori të zgjuar, që me batutat e tij si: "O drejtor, o shtrembëtor", "Partia nuk do kunja" etj. etj, kur rolin udhëheqës të partisë e kishim të sanksionuar në nenin 2 të Kushtetutës, ironizonte, krejt instinktivisht, "të Keqen e Madhe", vijën e partisë, të keqen që tentonte t'i vriste buzëqeshjen edhe recituesit të vogël, Dash Kolës, si fëmija i një familje të deklasuar. "Kush asht ky njeni që flet me spec në katun tanë, o shoku Gjelosh? Unë jam "i joni" qyshkur ti nuk je kenë as në bark të nënës. Ato fjalë që the janë palavina. Ti je partia, Partia nuk do kunja, ti ke me i pre ata kunja", - i drejtohet Mushaku. Dallëndyshja,

vajza himariote, që ka ardhur të punojë në Dukagjin si vullnetare, në frymën e lëvizjes së kohës: "Atje ku ka nevojë Atdheu është vendi im", apo "Një bije, mijëra ngrihen", pas rënies tragjike në ndërtimin vullnetar të hekurudhës Rrogzhinë-Fier, të 15-vjeçare, Shkurte Pal Vata, një lëvizje kjo integruese sa brenda zonës së Shalës, sa edhe brenda vendit, që u shoqërua me shkëmbim përvojash, lidhesh dhe miqësi të reja, të ndërsjellta, Veri-Jug, e cila do të ndikonte në emancipimin e jetës së një treve kaq të mbyllur, si Dukagjini, sa nga tradita e kodeve të vjetra zakonore, në rëndim të pashembullt mbi jetën ekonomike dhe shpirtërore, sidomos të grave dhe vajzave, po aq edhe nga natyra e ashpër, izolimi i gjatë nga dëborat. Njëkohësisht kontekst social, Dallëndyshja, një mësuese e përkushtuar, me talentet e reja në shkollë, me altruizmin e vet, ngrihet me kurajo në mbrojtje të nxënësit të saj, Dashit, : "E lashë për në fund pjesën e Dashit, si qersia mbi tortë. Është biri juaj, nxënësi i shkëlqyer, por edhe artisti i vërtetë. Jam krenar për këtë djalë, sepse jam e sigurt që do të ecë përpara dhe do të nderojë veten, familjen dhe Dukagjinin" i kundërvihet hapur Gjeloshit. "Parakaloni" me radhë në këtë roman, si një ansambël profilesh njerëzore nga më interesantet, figura të tilla të shquara të së kaluarës si: Mehmet Shpendi, Mar Lula, Mark Sadiku dhe pastaj të gjallët si: kryetari babaxhan i kooperatives, Halili, kryetari i këshillit popullor, Ujka, sikurse Pal Vata, malësori dukagjinasi nga më fisnikët, kryetari i shoqatës "Atdhetar-Dukagjini", Ndue Sanaj, "Mirënjohja e Qytetit të Shkodrës", nipi i Balë Marku, publicisti dhe poeti Prelë Milani, publicisti dhe kryeredaktori i gazetës "Dukagjini" Luigj Shyti, autorët e disa librave dhe publicistët malësorë në diasporë, Rush Dragu dhe Prof. Lulash N. Palushaj, intelektual Luigj Pepaj, sponsori në mbështetje të shoqatës në fjalë, biznesmeni Gjergj Leqeja, inxhinier Hekurani, akademiku me përvojë, drejtori defakto i minierës së Brazhdës, që në këtë minierë, ku flitej për zbulimin e një minerali me vlerë strategjike, e kishte sjell nevojën për të dhe jo besimin politik ndaj tij: "Kujton ti se nuk e dinë "ata", se unë shoh në stacione të huaja?", - i drejtohet Hekurani, Dashit, këshillë që, ky i fundit, do ta lidhte automatikisht në trurin e tij me porosinë e babë Kolës: "Ruaje, gjuhë, kokën!" etj. etj. Dhe, kështu duke e njohur "të keqen e madhe" që ligjëronte kudo dhe mbi këdo, sepse të gjithë ishim, kush më shumë e kush më pak, nën pushtetin e atij kazermimi total, tragjik-omik, që thirrje socializëm, inxhinier Hekurani ndjente obligim moral të shpëtojë nga pasojat e tij një djalë të talentuar si Dashi. Në të njëjtin kontekst, ku dukej se shpresa për jetën po humbte kuptimin e saj, ngaqë varfëria, si një oktapod i stërmadh, e kishte mbërthyer me tentakulat e saj si Dukagjinin po ashtu dhe gjithë Shqipërinë, shpaloset si mesazh jete, mjaft mbresëlënës, personazhi episodik i Xhixhës, shoqja e shkollës e Dashit, mbesa e bajraktarit të Shoshit, një vajzë e bukur, që rrezatonte freski dhe joshje femërore, edhe pse sapo kishte mbushur vetëm 14 vite jetë. Përballë saj shpaloset Dashi: një goxha djalë, trup mushkuloz, shikim të thellë, zhbriues, buzëqeshje të çiltër, mendalok për moshën që kishte. Xhixha dhe Dashi dy të rinj që ndjejnë tërheqjen e parë seksuale ndaj njëri-tjetrit si pohim i dashurisë së fuqishme të njeriut për jetën, pikërisht kur një pretendim i tillë në atë realitet jete dukej nga më absurdët. Ja, cili ishte Shoshi i viteve 80-të në biografinë e shpirtit të një poeti që, ndoshta si refleks i biografisë si ankth, vitet më të

bukura të jetës do t'i kalonte, si mësues, në Ndrejaj (Shosh):

"Pa merrni një shtëpi të Shoshit, / të parën që gjeni, merrni me çka brenda, kulm e themel, / dhe futeni, bie fjala, në Teatrin "Migjeni", / dhe shihni ç' shfaqje, ç' dramë që iu del!" (D. Kaçaj, vëllimi poetik "Qielli i syrit", fq. 26)

Në shenjë intimiteti erotik apo dashurie, djali i dhuron asaj një karamelë, që vajza e struk në gj, sepse aty e ka vendin gjëja e ëmbël", - i thotë Xhixha, Dashit. Megjithatë, mjerisht, edhe një ndjenjë kaq e fuqishme si dashuria është e detyruar t'i bindet absurdit të jetës zakonore, aq sa raportet më të natyrshme njerëzore vihen nën pushtetin e hezrogamisë: Gjaku mbetet gjak ...edhe pas një shekulli! Xhixha dhe Dashi, si pas këtij kodi, janë të detyruar tërë jetën të komunikojnë si motra me vëllanë. Kështu përfaqja dhe përputhja e faqeve mes tyre, si shprehja e vetme konkrete e mesazhit erotik, do të ruhet shumë gjatë si një kujtim i ëmbël, po aq sa do të detyrohet të shuhet nën kompleksin provincial të një incesti. "Dashit mori çiftelinë dhe këndoi një këngë baritore, këngë të dhimbshme, fatale, për një dashuri të pamundur, të paralizueshme. Xhixha e kuptoi se kënga ishte për të. Qante në heshtje dhe, ndërsa me një dorë fshinte lotët tinzarë, me dorën tjetër ledhatonte atë karamelën që ia kishte dhuruar Dashit, pra ia kishte dhuruar "vëllai"... "- nënvizon autori gjithë dhimbje dhe respekt ndaj këtij raporti mes të dashuruarve, si njëri nga raportet nga më njerëzorët në këtë botë. Dashit nuk e ka problem e kujt është Xhixha, aq më pak të motivohet nga fati i përbashkët i tyre, si të deklasuar. Ai ndjen trokitjen e parë në zemrën e tij të njomë, si vetë moshën e tij, e re, pra e do Xhixhën. Kjo është kryesorja dhe, pikërisht prej kësaj dashurie, do të vuajë gjatë shpirtërisht, por po ashtu do të detyrohet ta sakrifikojë dashurinë që ndjen për të. Dashit e kupton fatëqësinë e pashmangshme brenda vetvetes: Kodi zakonor nuk pranon ta njohë kodin e natyrshëm të zemrës, sepse ligjet e egra të kanunit kanë vrrarë ndjenjën më të shenjtë tek njeriu: Lirinë për të dashuruar sipas ligjeve të zemrës. Dikush mund të mendojë se kjo marrëdhënie mes dy adoleshentëve është një sajësë e autorit, ndryshe një fantazi e sëmurë e tij! "Romancierit nuk është zëdhënësi i askujt, veçse zëdhënësi i ideve të tij. Gjatë shkrimit të romanit ai dëgjon një tjetër zë, të ndryshëm nga ai i besimit moral, zë të cilin unë do të dëshiroja ta quaj "urtia e romanit". Romancierët e vërtetë dëgjojnë simfoninë e kësaj "urtie" mbi personale. Kjo shpjegon pse romanet e mëdhenj janë gjithmonë më tepër inteligjentë se autorët e tyre", - shprehej shkrimtari i shquar çek, Milan Kundera (M. Kundera, "Arti i romanit", fq. 174). Kështu, pra, autori në këtë sens është treguar shumë bindës: Dante, Poeti Kombëtar i Italisë, bash në këtë moshë u dashurua marrëzisht pas një vajze 13-vjeçare, të cilën do ta përjetësonte në personazhin e Beatrices, njëri nga karakteret letrare më të realizuara në tërë letërsinë botërore, krahas Helenes së Trojës të Homerit, Laurës së Petrarkës, Tatjanës së Pushkinit dhe Margaritës së Gëtes. Babai i Dashit, Kola, me 5 fëmijë në gjithë atë skamje, shihte tek Dashit, vetëm një të ardhme: Ikjen, braktisjen e vendit, sepse për çiftin e tij, atdheu qe kthyer në varr... "Do të ikë edhe ky fëmijë...sa t'i dirset mustaku dhe do ta lërë këtë vend ashtu si Gjeggji, si Toma, si..."- i ankohet të shoqes, Diellës. Ja konteksti shoqëror, ekonomik dhe shpirtëror, ja starti nga do të hidhej në përballjen me dallgët e

jetës Dashit, djali i një familje të deklasuar, kur instnkti i jetës, erosi i tij, si cilëndo qenie njerëzore e thërriste të realizonte vetveten! Ndryshe nga zgjidhjet e ofruara në veprat e tjera të mirënjohura si shkrimtar dhe dramaturg realist lidhur me fatin e personazheve të tij, shkrimtari Fadil Kraja në këtë roman na ofron një vizion estetiko-filozofik zgjidhjeje shumë më të avancuar, si prirje drejt realizmit modern. Kjo përbën edhe njëherë nga risitë në filozofinë estetike të autorit, po aq edhe në dekodifikimin e kodit të realizimit postmodern të vetvetes, si mesazhi bosht që përcjell mes nesh romani "Guxo!..." i "Mjeshtrit të Madh" Fadil Kraja. E vetmja figurë që dominon, apo përçon filozofinë bazë, filozofinë individualiste të romanit, si linja bosht e tij, është ajo e Dash Kolës, figurë e cila sikur arrin t'i imponohet, së paku moralisht, me sukses, figurës së Gjeloshit si përfaqësues i filozofisë totalitare. Nga pikëpamja estetiko-filozofike kjo ngjet për dy arsye: E para, nëse Dashit në përpjekjen për gjetjen e vetvetes mbështetet "së jashtmi" nga ana e personazheve dytësore, reale si: Bala, Halili, Gjoni, Dallëndyshja, Mushaku, etj. etj nga pozitat e sentimentalizmit provincial, "së brendshmi" të gjithë këta më shumë se sa përkrahës të Dashit, filozofisë së tij individualiste, janë mbështetës të filozofisë totalitare, që përfaqëson Gjeloshin, apo Sadiku. Ndërkohë Dashit, në shijen e tij, edhe pse "së brendshmi" nuk e gjen vetveten në filozofinë totalitare, apo atë tradicionale, të atyre që e rrethojnë, "së jashtmi" nuk mund të shkëputet nga mjedisi ku jeton, aq më pak t'i kundërvihet atij. Ndërkohë, nëse Dashit "së jashtmi" ka një përplasje me Gjeloshin, kjo nuk vjen si një raport "frontesh", antagonizmi, por si një raport ekzistencial, sepse figura e Gjeloshit, ashtu anemike, thjesht deklarative, pa mbështetje reale nga autoritetet lokale si: kryetari i kooperativës, Halili, kryetari i pushtetit, Ujka, drejtori i shkollës, Burhani dhe mësuese Dallëndyshja etj. përfshirë edhe vdekjen e tij groteske, të parakohshme, nuk është bindëse, ndryshe nuk ka vërtetësi historike, kur kujtojmë që, në ato vite, diktatura jetonte lulëzimin e saj. Dashit "së brendshmi" vjen si bartës i një filozofie të re, asaj të individualizmit borgjez, aq sa si "hero kryesor" arrin "t'i imponohet" aq fuqishëm autorit, sa ky i fundit, instinktivisht, detyrohet të braktisë brenda vetes filozofinë estetike të realizmit klasik, tradicional, të karaktereve tipike në rrethana tipike si filozofia estetike dominuese tek ai si krijues. Tek Dashit gjithçka e tij vjen "së brendshmi", jo si bartës i optimizmit të madh, jo si "heroi pozitiv", që kërkon të rregullojë botën sipas motos sunduese të kohës: "Interesi i përgjithshëm mbi atë personal". Përkundrazi, si individualist, vetveten, egon e tij, Dashit e sheh si qendra e botës. Ai ndihet padroni i situatave dhe arritjeve me limit plotësimin maksimal të vetvetes. Në shkollë, në fshat, në minierë, në hidrocentral, në biznes, brenda vendit, po aq edhe në Amerikën e largët, sikur edhe në kontaktet dhe bashkëpunimin mjedisor, ku punon e jeton, Dashit afirmohet si njeri praktik, punëdashës dhe me shije jo të zakonshme prej njeriu pragmatist, që arrin të komunikojë në harmoni të përgjithshme, me të gjithë, në mjedisin ku vepron. Falë stilit të tij të komunikimit, prej pragmatisti të spikatur, ai gjithëherë rezulton kundër izolimit dhe konfrontimit, prandaj nuk ia lejon vetes asnjëherë prej tyre "së jashtmi", as "së brendshmi". Ai nuk është përjashtues, po aq nuk e njuh euforinë e së ardhmes së lumtur, njeh vetëm vullnetin dhe guximin për të realizuar maksimalisht vetveten përmes punës në çdo rrethanë. E vetmja moto që e udhëheq në jetë është: "Lumturia personale dhe familjare, lumturia për gruan dhe dy vajzat, që i ndjen aq afër edhe atëherë kur, në emër të kësaj lumturie, ka marrë rrugën e emigrimit

# Njeriu - e vetmja qenie vendimmarrëse

Biologjikisht njeriu është i pajisur me aftësinë e vendimmarrjes, ndryshe nga të gjitha qeniet e tjera të gjalla. Sipas studiuesit të trurit, Ernst Poeppel, njeriu merr deri në 20 mijë vendime në ditë, shumica e të cilave janë vendime „bliz“. Shpesh, vetë njeriu si vendimmarrës, nuk e din se çfarë donë. Ti mund të vendosësh për të shkuar në kafe me shokët ose të qëndrosh në shtëpi. Ti mund të vendosësh për ta bërë rrugën me dikë ose vetëm. Kjo është një gjë e njohur dhe e bëjmë të gjithë. Në çdo situatë dhe rrethanë, ti mund të vendosësh të varësh hundën apo të qeshësh dhe t'i fusësh një mendje të lehtë. Ti mund të vendosësh që, gabimet, shqetësimet e partnerit tënd, të prindërve, shokëve dhe kolegëve, t'i shikosh me vëmendjen më të madhe dhe të qëndrosh gjithnjë në gatishmëri lufte me ata, por edhe mund të vendosësh që të mos i shikosh fare ato dhe të jetosh në paqe me të gjithë. Ti për çdo rast mund të vendosësh që energjitë e tua t'i harxhosh për rritjen e vlerave dhe cilësisë së jetës tënde ose në luftë me të tjerët, thjeshtë se ti nuk mund të pajtohesh me ata. Ti mund të vendosësh për të mos falur kurrë, për të mbetur një fanatik i vërtetë ose për të qenë një njeri normal, modern, human i cili din të falë dhe falë. Ti mund të heshtësh, mund të flasësh, mund të grindesh apo mënjano konfliktet e mundshme me të tjerët. Ti e ke shkallën tënde të jetës, ashtu si gjithë të tjerët, në të cilën mund të ngjitesh apo zbresësh. Është thjeshtë vendimi yt. Ti mund të vendosësh të jetosh aty ku ke jetuar deri tani dhe siç ke jetuar deri tani ose mund të marrësh një vendim tjetër. Ti mund të vendosësh për hakmarrje apo gjakmarrje ose për falje. Ti e vendosë atë. Kurë them, ti e vendosë atë, do të thotë se gjithçka që ti bën, është ajo që ti dëshiron plus vullneti yt. Nëse ti vret, ky ishte vendimi yt i cili erdhi si rezultat i dëshirës tënde dhe vullnetit tënd, aspak prej hallit. Ajo që ti bën, gjithmonë është ajo që ti dëshiron, është vullneti dhe dëshira e jote. Veprimet e tua, janë pasqyrë e dëshirave dhe vullneteve të tua. Nëse ti e shikon komshiun se nuk ka qejf të komunikojë me ty, ti e mendon se ai ka diçka kundër teje. E mendon se brenda tij është zhvilluar një dëshirë dhe një vullnet tjetër ndaj teje. Dhe ti merre vendim në qëndrimin ndaj tij. Meqenëse ai nuk më flet, edhe unë nuk do ti flas, nëse ai më urren, edhe unë do ta urrej. Nëse ai për-

gatitet për luftë kundër meje, edhe unë do të përgatitem për luftë kundër tij. Këto janë vendime të mundshme të njeriut fanatik dhe primitiv, por njeriu human dhe modern natyrisht që merr vendime të tjera.

Vendimet që ti merr përcaktojnë kualitetin e jetës tënde. Ti mund të vendosësh të sillesh si palloi i cili është gjithmonë i gëzuar dhe ecën me kokën lart duke u mburrur me puplat e tij të bukura, pa i ven re këmbët e veta të shëmtuara. Ti mund të sillesh edhe si Davidi përballë Goliathit gjigand. Judët të cilët ishin grumbulluar për të parë dyluftimin midis Davidit dhe Goliathit gjigand, dridheshin nga frika dhe mendonin: "Sa i vogël është ky dhe sa i madh është ai tjetri. Davidi nuk e mposhtë kurrë atë ...". Por Davidi mendonte një gjë krejt tjetër: "Mrekulli që ai është kaq i madh, sido që ta qëlloj, diku do ti bie ...". Vetëm ti mund ta vendosësh se si ta shikosh botën, bardh e zi apo kolor.

Principi se njeriu është një qenie vendimmarrëse, përfshinë shumë më tepër se sa vendimmarrjen. Nuk është fjala se njeriu vendosë kështu ose ashtu, fjala është se njeriu nuk jeton dot pa vendimmarrje. Njeriu, ashtu siç nuk komandon dot frymëmarrjen, nuk komandon dot as vendimmarrjen. Për aq kohë sa njeriu jeton, nuk heq dorë nga vendimmarrjet, sepse nuk mund të heq dorë. Kështu është programuar ai nga natyra, qenie vendimmarrëse. Gjithçka që ti bën, ndjen, mendon, pret ose ëndërron, janë produkte të tuat, shumica prej tyre, vendimmarrje të pavetëdijshme. Në veprimtarinë e përditshme, njeriu merr shumë pak vendime në mënyrë të vetëdijshme. Pjesa më e madhe e tyre janë të pavetëdijshme, prandaj, kurë njeriu bën bilancin e veprimtarisë së vet ditore, shpesh mendon: Pse dhe si e bëra unë këtë apo atë veprim. Dhe nuk merr përgjigje, se nuk ka nga kush të marrë. Nëse njeriu, i ulur në tavolinë apo duke ecur rrugës, kruan hundën me gisht, është e qartë se gishti nuk ka faj. Gishti nuk ka jetë të pavarur nga njeriu, kështu që për çdo rast ai komandohet nga truri i njeriut, d m th lëvizjet dhe veprimet e tij janë vendimmarrje e njeriut. Njeriu ka vendosur: "Unë do të eci dhe njëkohësisht do të kruaj hundën me gisht ...". Nëse babai zemërohet me fëmijën e vet dhe e godet atë, kjo nuk është rastësi, është vendimmarrje e tij e pastër. Ai ka vendosur: Të zemërohet nga sjellja e fëmijës së vet dhe ta rrahë atë. Justifikimet se, unë nuk doja ta

rrihja fëmijën apo nuk doja ta kruaja hundën me gisht, por ishte fëmija që me bezdisi dhe hunda që u krua, janë teorikisht, të papranueshme dhe mjegullojnë shikimin tonë ndaj të vërtetës. Nëse dikush ndjehet i trishtuar dhe kërkon të fshihet diku me trishtimin e vet ai mund të mendojë: "Kam vendosur të jem i trishtuar dhe të fshihem diku në një qoshe ...". Vetëm ai mund ta marrë këtë vendim dhe t'i komandojë muskujt e fytyrës së vet në mënyrë të atillë që ta tregojnë sam ë te trishtuar. Kush tjetër?

Në sjelljet dhe veprimtaritë e njeriut, asgjë nuk është e rastësishme, gjithçka është vendimmarrje e tij, çka do të thotë se gjithçka është dëshira dhe vullneti i tij. Nuk është gishti ai që vret njeriun, por është vendimi i vrasësit njeri, vendim ky që ka ardhur nga dëshira dhe vullneti i tij për të vrarë dikë tjetër dhe që e përdorë gishtin thjeshtë si mjet vrasje. Arsyet, pse njerëzit, kaq shumë njerëz, marrin vendime të pasuksesshme në jetë, janë të ndryshëm, por unë do të përmendi dy prej tyre, në mënyrë e të menduarit dhe edukatën feminare.

Natyra i ka pajisur të gjithë njerëzit me aftësinë e të menduarit, por cilësia, po vetë nga natyra, është shpërndarë në mënyrë më të pabarabartë tek individët. Është e pamundur që të gesh dy njerëz që, në të njëjtën kohë, të mendojnë plotësisht në të njëjtën mënyrë për të njëjtën gjë. Aty ku të gjithë mendojnë se janë në gjendje të mendojnë, nuk ka mendim, ka vetëm anarki. Sot, njeriu i ditur është rralluar aq shumë, si ata që vdesin. Njeriu i egër, barbar, fanatik, në të gjitha rastet e konflikteve, e mendon dhunën si mjetin më të mirë për zgjidhjen e tyre dhe vendosë për dhunën. Njeriu human, modern, në të gjitha rastet e konflikteve, mendon se dhuna është mjeti më i pasuksesshëm për zgjidhjen e tyre dhe e përjashton atë. Injoranti nuk ja din vendbanimin të diturit dhe as diturisë, prandaj gjithnjë ecën në rrugën e errësirës, deri sa thyen kokën diku. Mënyra e të menduarit është produkt i të mësuarit dhe edukimit të njeriut. Nëse do të mendonim një diagnozë të përbashkët të njerëzimit, sëmundje kronike e të gjithëve, ajo do të ishte: Cilësi e ulët e të menduarit. Zhvillimi i të menduarit tek njeriu fillon që në hapat e parë të jetës së tij, menjëherë pas lindjes. Shume të rritur rikthehen me shumë dëshirë ne periudhën e artë të fëmijërisë së tyre pasi ata e kanë për-

jetuar si te tillë. Shumë të tjerë e kujtojnë atë si ferr, pasi e kanë përjetuar si ferr. Ata kujtojnë keqtrajtimet e padrejtë, poshtërimet, presionin për të qenë perfekt dhe ndëshkimet e ashpra për gabimet e tyre. Kujtojnë vuajtjet shpirtërore nga kërkesat e mëdha të prindërve të tyre egoistë, ndjenjën e pasigurisë nga ndarja e prindërve, frikën e dhunës nga prindër e alkoolizuar, plagosjet nga rrahjet, panikun e mbylles diku në një qoshe të errët apo nxjerrjen jashtë, dhuna seksuale etj. Ata kujtojnë braktisjen, vetminë, pasdorelënien, varfërinë, dhe me të drejtë mendojnë se nuk kanë asgjë të përbashkët me shokët e tyre dhe me jetën. Është e vështirë për ta kuptuar secili se, midis fëmijërisë dhe të tanishmes tek çdo person ka një lidhje të pazgjidhshme. Fëmijëria e jonë influencën të gjithë jetën tonë. askush nuk është aq i rritur sa duket, ne jemi fëmije nën lëkurën e vjetër. Brenda nesh, nën lëkurën e vjetër, jeton fëmijëria e jonë, dhe ne bashkë me atë. Nëse ti kundërshton apo dëshiron diçka, ti nuk e din kush kundërshton, ti si i rritur apo fëmija brenda teje. Në moshën feminare, shumë prindër edukojnë tek fëmijët e tyre frikën nga qeni dhe kurë ata rriten e ndjejnë përsëri atë frikë, por nuk e din se kush e ndjen atë, ai si i rritur apo fëmija brenda tij. Njeriu plakët nga jashtë por nga brenda mbetet fëmija i vet, fëmijëria e tij. Shumë të rritur kanë frikë nga rrufeja apo errësira, këta janë ata që edhe në fëmijërinë e tyre e kanë përjetuar këtë frikë. Nëse dikush në fëmijërinë e tij ka përjetuar dhunë, është fare e mundshme që në të gjitha rastet e konflikteve me të tjerët të përdorë dhunën, pa e ditur nëse është ai i rrituri që sillet kështu apo fëmija brenda tij. Do të ishte mirë që për shumë gjëra, i rrituri të ndahet nga fëmijëria e vet, por është e vështirë. Është fëmija brenda nesh që na paralajmëron rrezikun nga qeni, nga rrufeja, nga errësira, nga dhunuesi. Shpesh zemërohemi me veten tonë për vendimet tona të pasuksesshme, por shpejt e harrojmë këtë dhe sillemi përsëri si më parë, sikur nuk ka ndodhur asgjë. Ne sillemi me veten tonë ashtu siç janë sjell prindit me ne kurë ishim të vegjël dha kaq. Asgjë nuk ndryshon. sigurisht që pjesa më e madhe e të rriturve, të cilët kanë përjetuar një fëmijëri të dështuar, janë mendimtarë të dobët dhe vendimmarrës të pasuksesshëm. Duhet besuar dhe vlerësuar thënia e Jean-Jacques Russeau se: Edukimi i njeriut fillon menjëherë me lindjen e tij: para se ai shikon dhe dëgjon, fillon mësimin. Përvoja vjen me të mësuarit.

Lekë Imeraj  
shkrimtar dhe përkthyes

të largët, atje në SHBA-ës, çka sipas tij është i vetmi burim që më jep mundësi të investohem edhe për lumturinë e të tjerëve. Kjo ka bërë që të kultivojë brenda vetvetes shpirtin e bamirësisë dhe po aq të mecenatit të shquar sa në diasporën e largët, po aq në vendlindjen e tij me të cilën jeton përherë shpirtërisht. Jo, rastësisht, ai kudo rrethohet nga dekorit i mbështetësve "së jashtëmi", po aq edhe "së brendshmi", falë devizës së tij filozofike, individualizmit borgjez: Duaje vetveten, sepse kështu do të duan më shumë të tjerët, çka shënon edhe atë moment të kalimit instinktiv të Krajës, si romancier i mirënjohur tradicional, në rrafshin estetiko-filozofik të realizmit modern, ku sipas Kundrës: "Romanet e vërtetë janë gjithmonë më tepër inteligjentë se sa autorët e tyre, prandaj romancierët që janë më inteligjentë se sa vepra e tyre duhet të heqin dorë nga mjeshtëria e krijimit. (M. Kundera "Arti i romanit", fq.174).

A është bindës Dash Kola, si karakter letrar, në kontekstin e asaj diktature që kaluam, apo gjatë viteve të emigrimit jashtë atdheut,

apo thjesht kemi të bëjmë me një artific të autorit, apo një rënie të tij në pozitat e vultuarizmit estetik? Historia na mëson se sado diktatorial të jetë një sistem, model qeverisës, apo një regjim kazermë sui-generis, si yni, brenda vetvetes ai lind dhe rrit edhe fidanët që do ta shkatërrojnë atë, ashtu si vetë qenia njerëzore, që në ADN-n e vet krahas instinktit të jetës, erosit, është e destinuar të shijojë edhe fundin e saj, instinktin e vdekjes, thanatosin. Në vitet 80-të në historinë moderne të Evropës kishte ngritur siparin e saj Epoka e Individiumit, epoka e postskemave, e posthistorisë dhe e postideologjive. Ne shqiptarët kur pritej dhe, madje, na ofrohej ky shans nuk arritëm të kapnim këtë kod, kodin e epokës së njeriut të lirë, që dikton vetveten duke nxjerrë jashtëloje epokën e individit që diktohej prej të tjerëve. Fidanë të tillë kishin hapur krahët në mbarë Evropën Lindore, paçka se ne, në vetizolim tonë absurd, nuk po njihnim dot as vetveten, nuk po respektonim as ndjenjat tona, nuk po kapnim dot kodin e së ardhmes, falë verbërisë së politikanëve

tanë, tradicionalisht, mediokër dhe kulltukofagë të pandreqshëm, hijet vrastare të të cilëve vijnë të komprometojnë edhe sot rrugën e së ardhmes sonë demokratike. Një nga këta fidanë, që po rritej nën atë diktaturë sui-generis, të llojin të vet, paralajmëruet i Epokës së Individiumit, brenda vetes sonë, ishte edhe Dash Kola, "heroi ynë", që do të startonte sagën e vet sipas devizës individualiste: "Njeriu i lirë, zotëruet i kodit të gjetjes së vetvetes me dinjitet, ja Atdheun ynë më i sigurt". Në epokën e postnacionalizmit, si kod i Evropës së Bashkuar, nacionalizmi, ngado që të ofrohet, është vetëm regresiv, pra nuk ka nacionalizëm të mirë apo të keq, prandaj të gjitha format e shprehjes së tij estetike, të cilat rreken të ofrojnë nostalgjinë për kullat, kështjellat apo kombin etnikndryshe për etnonacionalizmin, pavarësisht nga përcaktimi i tij: shqiptar, serb, grek etj. janë shprehje anakronike ndjellakeqe, kur dihet që në ditët tona dashuria për atdheun vjen si një vlerë demokratike, iluministe, ndryshe si dashuri për kombin qytetar, për bash-

kësinë e qytetarëve, nënkupton dashurinë për shtetin, për ligjin, për kulturën etj. si dhe për obligimet ndaj tyre duke vënë gjithnjë në epiqendër punën e ndershme, meritokracinë, respektimin maksimal të të drejtave të njeriut. Ky është edhe mësimi më domethënë, ndryshe mesazhi më vital, që përcjell romanin "Guxo!...", nëntitull : Saga e një shoshi-ani", i shkrimtarit Fadil Kraja dedikuar djalit të Shoshit, biznesmenit shqiptaro-amerikan në krah, në çdo kohë, të njerëzve në nevojë, sponsorizuesit model të veprimtarive nga më të larmishme në dobi të progresit tonë si komb qytetar : në diasporë, në trevën ku lindi dhe u rrit dhe shumë më gjerë, zotit Ndue Ftoni, gjithë rrezatim guximi dhe prosperiteti në Epokën e Individiumit, në gjirin e një shoqërie si e jona, që aspiron të ndërtojë të ardhmen e vet, demokratike, për vetveten dhe qytetarët e saj.

Kadri Ujkaj, kritik letrar

# Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare

Msc. Anelmo Spahija

Shfaqja e ekonomisë kapitaliste në Shqipëri ndodhi relativisht vonë, krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore, apo edhe me vendet fqinje ballkanike. Dominimi i tejzgatur i strukturave feudale dhe esnafëve deri në gjysmën e shek XIX, lidhet me faktin se vendi ynë ishte pjesë e Perandorisë Osmane, e cila duke filluar që nga shek. XVII ishte në dekadencë të plotë. Por, zhvillimi i shteteve perëndimore nuk mund të mos ndikonte edhe në Evropën Juglindore. Për shkak të dobësisë të vazhdueshme të saj dhe për të mundësuar mbijetesën e vet, PO (Perendoria Osmane) veçoi në dy mënyra: Së pari, u detyra që t'i lejonte një regjim preferencial ndaj mallrave që borgjezia evropiane eksportonte në perandori. Këto të drejta që tregtarët e më vonë shoqëritë monopoliste evropiane gëzonin njihen si kapitulatione. Së dyti, Porta e Lartë ndërmoi një sërë reformash që synonin nga njëra anë rimëkëmbjen e makinës burokratike dhe administrative shtetërore sipas modelit perëndimor e nga ana tjetër shkatërrimin e strukturave tradicionale ekonomiko-shoqërore, dhe nxitjen e zhvillimit të një ekonomie kapitaliste. Pikërisht këto dy politika, patën rezultatet e tyre edhe në Shqipëri, dhe shërbyen si faktorë për shfaqjen e ekonomisë së tregut. Vërshimi i mallrave të huaja dhe konkurrenca që ata i bënin prodhuesve të vegjël artizanale ndikoi në dobësimin e esnafëve. Gjithashtu, vëshimi i kapitalit të huaj, sidomos italian dhe austro-hungarez, rriti kërkesën për krah të lirë pune, i cili mund të gjendej tek mjeshtrit artizanë të varfëruar, fshatarët e mbytur me borxhe etj. Nga ana tjetër, për t'i bërë ballë konkurrencës, disa tregtarë dhe mjeshtër, filluan të përdornin një teknologji më të avancuar për prodhimin. Kështu, më 1880 tregtarët shkodranë sillnin nga jashtë makineri për përpunimin e mëndafshit. Rritja e konkurrencës dhe futja e teknologjive të reja çon gradualisht drejt shturjes së esnafit, shfaqjes së një shtrese pronarësh të vegjël që shkon drejt falimentimit, e të një pakice që i mbijeton konkurrencës, shman punën e çirakut dhe kallfit dhe fillon të shfrytëzojë punën e punëtorit mëditës. Ndërkohë reformat e ndërmarra nga Porta e Lartë i zhvilluan më tej këto procese. Me dekret sulltanor u eliminuan privilegjet e esnafëve. Ndërkohë, depërtimi i marrëdhënieve kapitaliste në fshat u shoqërua përqëndrimin e tokave në duart e çifligarëve të mëdhenj dhe të borgjezisë agrare (fshatarë apo qytetarë të pasur që blinin tokat nga çifligarët), si dhe me varfërimin e vazhdueshëm të pjesës më të madhe të fshatarëve (nuk mund të përballonin konkurrencën nga prodhuesit e mëdhenj e si pasojë hyjnë në borxhe dhe rrënohen.), një pjesë e të cilëve mërgonin drejt qyteve vendase apo të huaja, dhe pjesa tjetër punonte me mëditje në tokat e çifligarëve apo fermerëve të pasur.

Pra, mund të themi se fillon të formohet bërthama e klasës punëtore, e cila del nga ish-mjeshtrit e rrënuar, çirakët dhe kallfët, si dhe fshatarët e varfëruar. Duhet të kemi parasysh se kushtet e punës në punishtet e para manufakture nuk ishin optimale. Punohej 12-14 orë në ditë, për një pagë

mesatare prej 5-6 grosh në ditë. Mund të përmendim rasin e grave përpunuese të mëndashit në Shkodër, të cilat punonin 16 orë për 6 grosh në ditë. Madje, në dimër kur dita ishte e shkurtër, ata detyroheshin që me shpenzimet e tyre të mbanin kandidin për të vazhduar punën. Në një gjendje të tillë ishin edhe punëtorët hamej, elhakçitë (vjen nga fjala hak-pagë) që punonin në punishte të ndryshme, larëset e leshit etj. Një gjendje e tillë varfërimi gradual, u shoqërua me reagimin që vinte nga njëra anë nga intelektualë të caktuar, dhe nga ana tjetër nga vetë vegjëlja, e përbërë nga këta artizanë dhe fshatarë të rrënuar që shkonin drejt pauperizimit. Kështu, në fillim të shek. XX fillon organizimi i kësaj vegjëlie në shoqëri ndihmëtare, ku përfshiheshin intelektualë, punëtorë, prodhues të vegjël artizanale, çirakë, kallfë e shegertë, interesat e të cilëve vinin gjithnjë duke u afruar. Dhe do të jetë pikërisht qyteti i Shkodrës, qytet me një zhvillim të madh ekonomik e shoqëror në Shqipërinë e atyre viteve, vatra ku do të lindin këto organizata.

Në mars 1905, me iniciativën e Kol Dikës, shitës ambulant, që njihet edhe si studiues i letërsisë perëndimore, u formua në Shkodër një grup i vogël ilegal, në të cilin bënin pjesë zejtarë dhe punëtorë, si dhe intelektualë (mjekë e farmacistë). Me iniciativën e tyre u formua një shoqëri punëtore për ndihmë reciproke. Dy mjekët që bënin pjesë në shoqëri vizitonin të sëmurët dhe jepnin barna falas. Shoqëria mbahej me kuotat e anëtarëve. Por autoritetet turke e gjurmuan këtë shoqëri, e cila nuk e pati jetën të gjatë. Po në vitin 1905, në Shkodër shpërthen greva e punëtorëve këpucëtar. Për të kapërcyer vështirësitë e tyre që vinin nga konkurrenca e prodhimeve të huaja dhe nga kriza ekonomike, mjeshtërartë ulën pagat dhe shtuan orët e punës, duke i detyruar punëtorët të punonin edhe natën me kandil. Prandaj, këta të fundit formuan një komision që paraqiti kërkesën për rritjen e pagave dhe pakësimin e orëve të punës. U vendos që asnjë punëtor të mos paraqitej në punë. Shpërtheu kështu greva e parë e punonjësve shqiptarë. Të 60 e ca grevistët marshuan nëpër rrugët e qytetit duke kënduar, deri sa u mblodhën jashtë qytetit, ku u fol për grevën, të drejtat e punëtorëve etj. Por autoritetet turke, me thirrjen e pronarëve të punishteve, ndërhyjnë dhe arrestuan disa nga krerët e lëvizjes. Kundërpërgjigjja e punëtorëve që gjithashtu violente. Të zemëruar ata iu drejtuan punishtes së mjeshtrit Palok Kiri, ku thyen xhamat, shpërndanë e nxorën në rrugë veglat e punishtes. Si përfundim, pronarët u detyruan të bëjnë lëshime dhe të pranojnë kërkesën e punëtorëve që "të punohej pa kandil" (pra të pakësoheshin orët e punës) dhe të rritej rroga me një grosh e gjysmë. Greva që bënë punonjësit këpucëtarë nxiti gjithashtu grevën e punëtorëve të duhanit. Me 1 prill 1907 u formua "Shoqëria ndihmëtare", e cila sipas një lajmërimi në gazetën "Drita" kishte për qëllim të ndihonte të varfërit e të sëmurët duke u dërguar mjekun dhe barnat pa të holla. Edhe kjo shoqëri mbahej me kuotat e anëtarëve. Ajo pati jehonë të gjerë në Shkodër dhe në shtypin vendas e të diasporës, i cili vinte në dukje

faktin se anëtarët e saj mësonin shkrimin dhe këndimin shqip dhe përhapnin idetë përparimtare. Megjithatë nën presionin e autoriteteve turke dhe atyre klerikale shoqëria pushoi së funksionuar. Në shtator, u arrestuan udhëheqësit e shoqërisë dhe u sekuestruan të gjitha orenditë e zyrës, librat defteret etj. Të ngjashme me të u krijuan edhe "klubi i detarëve" dhe një shoqëri tjetër ndihmëtare në vitin 1912. Sipas gazetës "Shpresa e Shqipërisë" që botohej në Dubrovnik, në vitin 1907 u festua për herë të parë 1 maji: "Sot në ditën e parë të Majit, siç asht zakoni në të gjithë botën, punëtorët me shumë të tjerë dalin për me përgëzumin pranverën. Kështu pra u ba edhe këtu në Shkodër sivjet. U mblodhëm na dhe heret të gjithë së bashku punëtorë, shegertë e të tjerë pa numër, e dulëm tue këndue valle... U gëzue gjithë qyteti me ne, e kemi shpnesë me tjera herë gëzimi e lulëzimi ka me qenë edhe ma i plotë e i fortë, sepse përgjithë vjet' asht tuj u afri dita e lirisë e përparimit, e mirësimi të përgjithshëm". Ky artikull, i shkruar nga autori me pseudonimin "I Mjeri", përfundonte me thirrjen: "Rrnoftë Shqipëria e lirueme! Rrnoftë vllaznia e bashkënia! Rrnoftë e para ditë e Majit!".

Tendenca për formimin dhe forcimin e organizatave punëtore e profesionale u zhvillua më tej pas Lufës I Botërore. Kjo lidhet me dy faktorë kryesorë. Së pari, pas vitit 1918 pati një rritje në numër të klasës punëtore. Kapitali shqiptar, si pasojë e çlirimit nga pengesat që më parë krijonte shteti osman, tashmë kishte rrugë të lirë të zhvillohej. Kështu u ngritën disa fabrika si fabrikat e sapunit (1918), alkoolit (1922), bombonave në Shkodër, fabrika e cigareve në Durrës (1920), si dhe u ngritën disa shoqëri anonime si "Stamles" në Durrës, "Maliq" etj. Ky zhvillim i industrisë së lehtë dhe i borgjezisë kombëtare nxiti rritjen në numër të klasës punëtore. Kjo rritje e numrit të punëtorëve erdhi edhe nga roli gjithnjë e më i madh që luajti kapitali i huaj, e sidomos ai italian. Kështu në minierën e Selenicës e cila ishte marrë me koncesion nga grupi italian "Parodi e Delfini" punonin rreth 500 punëtorë. Duke bashkuar numrin e punëtorëve të punishteve të vogla, me atë të punonjësve të industrisë, mund të themi se numri i tyre shkon në rreth 19000. Së dyti, formimi dhe forcimi i organizatave punëtore e profesionale u nxit edhe nga përkeqësimi i kushteve të jetesës, që shoqëroi vitet e pasluftës jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë Europën. Pagat e ulëta dhe mungesa e te drejtave minimale në vendin e punës e bënin të pamundur për punëtorin shqiptar të përballonte ngritjen e çmimeve. Gazeta "Ora e Maleve" që botohej në Shkodër, në prill 1923 shkruante: "Kaq poshtë ka ra sod punëtori sa me tu xanë sytë me e shikjue". Përveç kësaj, mungonin rregullat minimale për sigurinë në punë e për pasojë aksidentet ishin të shumta. Ndërkaq, në punë merreshin edhe fëmijë të moshave të reja nën 16 vjeç.

Prandaj, si reagim ndaj kësaj situatë, kalohet në një fazë tjetër të lëvizjes së organizuar punëtore. Tashmë krijohen organizata e shoqëri, të cilat kanë një program gjithnjë e më të qartë, ndryshe nga shoqëritë e para që kishin vetëm funksion ndihme e bamirësie. Më 1920, në Shkodër, me iniciativën e një grupi zejtarësh e punëtorësh u formua "Shoqëria ndihmëtare e punëtorisë". Në rregulloren e botuar shpallëshin qëllimet e shoqërisë, ku përf-

shihej: shërbim mjekësor falas për punëtorët, krijimi i një zyre pune, krijimi i një kase huaje për të ndihmuar punëtorët në vështirësi etj. Shoqëria bëri një hap përparimtar me ngritjen e organizatave të veçanta sipas profesioneve. Të tilla ishin 17. Në krye të secilës organizatë profesionale caktohej nga një kujdestar. Nga përfaqësuesit e këtyre organizatave ngruhej këshili i Shoqërisë ndihmëtarë të Punëtorisë. Shoqëria kishte një kryetar, një sekretar dhe një arkëtar. Në sajë të këtij organizimi dhe të veprimtarisë që zhvilloi, shoqëria arriti të përfshinte në rradhët e saj deri në 800 anëtarë. Nën drejtimin e kësaj shoqërie u organizuan greva e demonstrata, ku mund të veçojmë demonstratën e 1 Majit 1922, ku punëtorët të ndarë sipas profesioneve parakaluan nëpër rrugët e qytetit, si dhe u mbajtën fjalime.

Me rëndësi për këtë periudhë është edhe greva e punëtorëve të minierës së Selenicës, që siç e përmendëm më lart zotërohej nga një kompani italiane. Problemeve të pagave të ulëta, ndotjes dhe ungesës së sigurisë në punë, i shtoheshin edhe keqtrajtimi dhe përbuzja që shfaqej inxhinierët italianë ndaj punëtorit shqiptar, si dhe spekulimi me çmimin e drithit, që shoqëria ia shiste punëtorëve me kredi, duke i mbajtur ata të lidhur pas vetes. Duke shfrytëzuar këkesën e lartë për drithë, kompania ia shiste atë me çmime të larta punëtorëve. Në pamundësi për të duruar më tej një gjendje të tillë, në tetor 1923 punëtorët nisën grevën e përgjithshme e cila bashkoi njëri pas tjetrit punëtorët e galerive, punëtorët e pastrimit të impiantit të bitumit dhe të transportit. Komisioni i punonjësve që u ngrit i paraqiti shoqërisë një peticion me shkrim, ku kërkohej rritja e pagave, pakësimi i orëve të punës, përmirësimi i kushteve të punës, sigurimi i punëtorëve që semureshin ose aksidentoheshin, si dhe largimi i disa kryepunëtorëve italianë e shqiptarë që sillleshin keq me punëtorët. Fillimisht këto kërkesa nuk u pranuan nga shoqëria, e cila kërcënoi se do të punësonte punëtorët të tjerë. Megjithë vështirësitë e krijuara, greva pati sukses për shkak se me punëtorët u bashkuar edhe banorët e fshatrave përreth. Pas një muaji, shoqëria u detyrua të pranonte shtimin e pagave me 30-50%, pushimin nga puna dhe transferimin e disa inspektorëve dhe sigurimin e shërbimit mjekësor për punëtorët në rast nevojë.

Në fillimin e viteve 20' fillon të shfaqet edhe një lëvizje e organizimit të arsimitarëve. Në një artikull të gazetës "Kuvendi", që botohej në Romë përshkruhej gjendja dhe vështirësitë që hasnin ata në jetën e përditshme: "Mësuesit nuk janë kamës. Edhe në konditat e këqija që rrojnë sot atyre nuk u arrin rroga. Ç'bëhet kur ata sëmuren, kur ata mplaken?". Kështu fillojnë të ngrihen në disa qytete të vendit organizatat profesionale të mësuesve. Në korrik 1921, me inisiativën patriotit Avni Rustemi formohet në Gjirokastrë "Lidhja e mësuesve", në programin e së cilës përfshihej mbrojtja e të drejtave të mësuesve. Përveç problemit të pagave të ulëta, shumë prej mësuesve nuk u paguhej rroga me rregull. Pikërisht një problem i tillë u trajtua në Kongresin e Arsimitarëve që u mbajt në Tiranë në gusht 1923. Në fillim të vitit 1924, në qytete të ndryshme, si Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë etj, filluan të organizoheshin protesta e greva nga ana e arsimitarëve. Vlen të përmendet sidomos greva e mësuesve të Korçës, të cilët

# HOTI NDER RRJEDHAT E SHEKUJVE

Në mjediset e Bibliotekës Shkencore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në sallën "Walter Hoflechner" u zhvillua ceremonia e paraqitjes të botimit "Hoti ndër rrjedhat e shekujve". Morën pjesë shume intelektual, pushtetar e miq nga Malësia në republikën e Malit të Zi, nga Kosova, nga Durrësi e vende të tjera, në veçanti me origjinë nga Hoti. Ceremoninë e hapi profesor doktor Mahir Hoti, i cili pasi ju uroj mirëseardhjen pjesëmarrëseve, i dha fjalën Ma. Nikolle Camaj, i cili njohi pjesëmarrësit me punën që është bere në Miçigan për këtë konference shkencore, materialet e së cilit janë botuar në këtë libër. Më pas e morën fjalën akademiku Kolec Topalli, Prof. dr. Romeo Gurakuqi dhe Prof.dr. Mahir Hoti. Në fund pati dhe mendime nga pjesëmarrësit, mes të cilëve Tomë Camaj, Nikollë Spathari etj.. Kjo ceremoni u mbyll me një koktej.

Korrespondenti i "Dukagjini"



◀ kërkoni dhënien e rrogave të prapambetura. Lëvizja mori shkallë të gjerë, pasi me mësuesit e qytetit u bashkuan edhe ato të fshatit, gjë që çoi në mbylljen e pjesës më të madhe të shkollave në të gjithë rrethin. Gazeta "Shqiptari i Amerikës", duke përshkruar situatën e krijuar, shkruante: "Populli shpirtërisht është i lidhur me mësonjësit. Ai tregon simpati të madhe për përçapjen e mësonjëseve të vendur për një durim të gjatë e shembullor". Prandaj, përpara një situatë të tillë, qeveria u detyrua të tërhiqej dhe të paguante rrogat e prapambetura. Pas revolucionit të qershorit 1924, lëvizjet punëtore e sindikaliste shkojnë drejt shuarjes. Rikthimi i Zogut në pushtet, u shoqërua përkohësisht me eliminimin e të gjithë zërave opozitar dhe protestues. Megjithatë siç do të shohim më poshtë, kriza botërore ekonomike, e cila pati ndikimin e saj edhe në Shqipëri, ndikoi në nxitjen e lëvizjeve të tilla, dhe kalimin e tyre në një fazë të re, më të organizuar.

Duke filluar që nga viti 1930, Shqipëria u ndodh në një situatë të rënduar ekonomike, e cila vinte si rezultat i Krizës ekonomike të kapitalizmit (1929-1933). Si një vend i prapambetur bujqësor, Shqipëria varrej nga tregu i jashtëm. Me fillimin e krizës ekonomike, shtetet me të cilat Shqipëria zhvillonte tregtinë, si Italia, Greqia, Turqia, ShBA etj, ndoqën politika proteksioniste, që ndikuan në rënien drastike të eksporteve shqiptare. Pakësimi i eksporteve krijoi një kontigjent prodhimesh të tepërta, gjë që çoi në rënien e çmimeve. Kjo krijoi vështirësi për prodhuesit vendas, që nga industrialistët e paktë e deri tek prodhuesit e vegjël të fshatit dhe qytetit, dhe çoi shumë prej tyre drejt rrënimit. Rënia e çmimeve dhe pakësimi i fuqisë blerëse çoi në falimentimin e tyre dhe u shoqërua me rritjen e papunësisë, përhapjen në mënyrë masive të varfërisë etj. Këtë situatë të vështirë e vuajtën kryesisht prodhuesit e vegjël të fshatit, për shkak se prodhimet e tyre blegtorale, që përbënin 60-70% të eksportimeve të Shqipërisë, duke mos gjetur tregje shitjeje jashtë vendit, pësuan një ulje të ndjeshme të çmimeve. Gjithashtu, shumica dërrmuese e zejtarëve u rrënuan ekonomikisht, ndërkohë që shumë fabrika si SCALA, dega e STAMLES në Shkodër etj, e ndërprejnë prodhimin, gjë që çoi në rrënimin e disa degëve të industrisë si e çimentos, duhanit, alkoolit, blajës, etj. Rritja

e papunësisë në vendet e zhvilluara kapitaliste ndikoi në pakësimin e të ardhurave të siguruar nga dërgesat në të holla të emigrantëve. Edhe kreditë e SVEA-s pësuan rënie.

Kjo gjendje e vështirë ekonomike ndikoi gjithashtu edhe në rritjen e papunësisë. Deflacioni detyroi fabrikat dhe punishtet që të pakësonin numrin e punëtorëve e të ulnin pagat. Orët e punës vazhdonin të ishin të gjata (mesatarisht 12), ndërkohë që kushtet dhe siguria në punë as që llogariteshin. Kriza çoi drejt falimentimit edhe mjaft prodhues të vegjël të qytetit e të fshatit që u gjendën të papunë. Kjo gjendje e rënduar e shtresave punonjëse reflektohej edhe në shtypin e kohës. Gazeta "Ora" evidentonte faktin që nuk kishte asnjë rregullore që të përcaktonte marrëdhëniet mes pronarit dhe punëtorit: "Nuk ka kontrato të shkruar, nuk ka kontrato kolektive, nuk ka ligje, nuk ka rregullore...". Ndërkohë, tek "Shqipëria e Re", në një artikull të janarit 1930 vihej në dukje se në fabrikën Stamles punonin edhe të mitur: "Këtu më hoqi vëmendjen një tok 7-8 çupash prej 6 deri 8 vjeç, të cilat shumë të bindura, me doçkat e tyre të vogla, po thyenin anët e kutive të cigareve me një shpejtësi të madhe. Të thyhet zemra duke parë këto foshnja të marrin përsipër që sot gajlen e ekzistencës dhe të jetës...". Në një gjendje të tillë, të rritjes së papunësisë, të rënies së fuqisë blerëse, dhe të pauperizimit të përgjithshëm rifillon organizimi nga ana e punëtorëve dhe krijimi i shoqërive me karakter profesional.

Në janar 1934 në Korçë u themelua "Shoqëria e Punëtorëve rrobaqepës të Korçës". Programi i saj përfshinte: punën për grumbullimin e të gjithë punëtorëve rrobaqepës dhe të fabrikave tekstile në organizatë, ndihmën morale e materiale për të gjithë anëtarët, të luftohet në një fazë të parë që rrogat të mos ulen e punëtorët të mos pushohen nga puna e më pas të bëhen kërkesa për rritje pagash, gjetjen e punës për të papunët, pakësimin e orëve të punës etj. Ajo zhvilloi një veprimtari të dendur duke luftuar kundër abuzimit në punë të punëtorëve të mitur, dhe arriti në një marrëveshje me punëdhënësit për vëndosjen e një kufiri moshor. Gjithashtu, shoqëria bëri që të dështonin tentativat e disa pronarëve për rritjen e orareve të punës. Në vitin 1938, së bashku me organizatën sindikale të këpucëtarëve u organzua

edhe një fushatë për 8-orëshin në punë por pa sukses. Megjithatë, kjo organizatë sindikale pati edhe kufizimet e veta, pasi psh ndihmësve të profesionistëve nuk u njiheshin të drejta të barabarta me të tjerët. Nga ana tjetër shoqëria mbajti qëndrim armiqësor ndaj punonjësve sezonalë që vinin nga fshati.

Shoqëri të ngjashme, me elementët përparimtar, por edhe me kufizimet e tyre u përhapën në disa qytete të Shqipërisë. Por rolin kryesor e luajti shoqëria "Puna" e ngritur në Kuçovë nga punonjësit naf-tëtarë në Kuçovë, me iniciativën e një grupi prej 5 punëtorësh me në krye Mafuz Lazen. Tri shoqëritë që kishin marrë në koncesion naftën "Anglo-Persian Oil", "AIPA" dhe "SIMSA", sipas studiuesit Koço Misha përmbanin rreth 1800 punëtorë, të cilët jetonin në kushte të mjerueshme për të gjitha arsyet që radhitëm më sipër. Prandaj, shoqëria "Puna" i dërgoi një petition parlamentit dhe qeverisë shqiptare, ku paraqitej gjendja dhe kushtet e rënda të jetesës për punëtorët e Kuçovës, si dhe një sërë këkesash, për përmirësimin e situatës. Kërkesat kryesore që përfshinte petitionin ishin: **të detyrohet shoqëria AIPA t'i japë shpërblime familjeve të punëtorëve të vdekur ose të aksidentuar, të caktohet orari i punës prej 8 orësh, të merren masa nga shoqëria italiane për ndërtimin e barakave për fjetjen e punëtorëve dhe sigurimin e gjendjes së tyre shëndetësore, të hartoheshin rregullore që do të përcaktonin marrëdhënien mes punëtorëve dhe pronarëve, si dhe të caktoheshin nga ana e kompanisë italiane ditë e festave kombëtare si ditë pushim.** Duke hedhur një vështrim krahasues mbi këtë petition, mund të themi se këto ishin kërkesat më të avancuara që një organizatë sindikaliste kishte bërë në Shqipëri deri atëherë. Duke qenë se nuk morën mbështetje nga qeveria e drejtuar nga Mehdi Frashëri, me 5 janar 1936 shpërtheu greva. Pas 4 ditësh, duke qenë se nuk arriti të gjente grevëshyres për të zëvendësuar punëtorët, AIPA arriti në një marrëveshje me grevistët, ku përfshihej një rritje e vogël e pagave, si dhe pakësimi i orëve të punës në 10. Mirëpo, menjëherë pas kësaj, pronarët filluan të bënin presione për shkakimin nga puna të udhëheqësve të grevës. Gjithashtu, ata kërkuan edhe ndihmën e autoriteteve qeveritare shqiptare për shpërbërjen e shoqërisë "Puna". Presioni

i shoqërisë italiane bëhej edhe përmes gjobove të shpeshta që iu vunë punëtorëve. Një situatë e tillë, bëri që në fund të janarit, punëtorët e centralit elektrik të Kuçovës të fillonin grevën. Ndërkohë, prefekti i komunës lëshoi urdhërin që ata punëtorë që përfshiheshin në veprimtarinë e shoqërisë "Puna" të largoheshin nga Kuçova. Kështu, me 11 shkurt, si kundërpërgjigje, me iniciativën e organizatës sindikale rifilloi greva. Ndryshe nga një muaj më parë, punëtorët e të gjitha degëve ndalën punën. Ishte greva e përgjithshme! Revolta e punëtorëve nuk mund të ndalej ndryshe veçse me forcën e armëve. Vetë ministri i brendshëm, Et'hem Toto edhe në Kuçovë në krye të xhandarmërisë, dhe me 12 shkurt arresoi të gjithë anëtarët e shoqërisë "Puna", si dhe dha urdhrin për transferimin e 300 punëtorëve drejt qyteteve të tjera. Pjesa tjetër e punëtorëve, duke mos patur zgjidhje tjetër u detyrua t'i kthehej punës. Së fundi, nuk munguan edhe falenderimet e Legatës Italiane për rolin e luajtur nga autoritetet shqiptare: "Ndërhryja e ministrit të brendshëm na shpëtoi jo vetëm pse i dha fund grevës, por sepse masat e marra do jenë shembull për të ardhmen".

Me gjithë përfundimin aspak të dëshiruar, greva e punëtorëve të naftës në Kuçovë dhe krijimi i shoqërisë "Puna" përfaqësojnë stadin më të lartë në lëvizjen sindikaliste shqiptare. Ndryshe nga shoqëritë e mëparshme që përbëheshin jo vetëm nga punëtor, por edhe nga prodhues të vegjël artizanale, shoqëria Puna u ngrit si një organizatë sindikaliste që kishte si qëllim, në mënyrë ekskluzive mbrojtjen e interesave të punëtorëve. Vumë re kështu kalimin nga shoqëritë e para ndihmëtare, me karakter bamirës dhe të ndihmës reciproke mes punëtorëve, në organizatat e viteve 30' që marrin gjithnjë e më tepër karakter sindikalist, që kanë si qëllim final 8-orëshin e punës, hartimin e kontratave padron-punëtorë, sigurimin e të aksidentuarve në punë etj. Ky zhvillim dhe përvoja e karakterit të orgaizatave dhe shoqërive të tilla, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rritjen në numër të klasës punëtore në Shqipëri dhe kushtet e vështira në të cilat ajo gjendej, gjë që e bën t'i shprehë kërkesat e veta në mënyrë gjithnjë e më të organizuar.



**Janar**

H	M	M	E	P	Sh	D
			1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

**Shkurt**

H	M	M	E	P	Sh	D
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29						

**Mars**

H	M	M	E	P	Sh	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

**Prill**

H	M	M	E	P	Sh	D
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

**Maj**

H	M	M	E	P	Sh	D
2	3	4	5	6	7	1/8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

**Qershor**

H	M	M	E	P	Sh	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

**Korrik**

H	M	M	E	P	Sh	D
			1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

**Gusht**

H	M	M	E	P	Sh	D
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

**Shtator**

H	M	M	E	P	Sh	D
		1	2	3	4	
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

**Tetor**

H	M	M	E	P	Sh	D
			1	2		
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

**Nëntor**

H	M	M	E	P	Sh	D
1	2	3	4	5	6	
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

**Dhjetor**

H	M	M	E	P	Sh	D
		1	2	3	4	
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

**REDAKSIA**

Kryeredaktor: Luigj Shyti  
 Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
 Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

**GJERGJ LEQEJZA**

